

**PËRMIRËSIMI I QEVERISJES KORPORATIVE DHE
TRANSPARENCËS NË BANKA DHE KOMPANI TË SIGURIMIT
NË KOSOVË**

Ky raport hulumtues është pjesë e projektit të mbështetur nga Qendra për
Ndërmarrje Private Ndërkombëtare (CIPE), Uashington

Prill 2009

Autorë:

Prof. Muhamet Mustafa - udhëheqës i projektit
Sejdi Osmani – menaxher i projektit
Salvador Elmazi, MA - konsultant
Gëzim Tosuni, MSc - konsultant
Fadil Aliu, MSc – hulumtues i lartë

Ekipi anketues dhe hulumtues:

Artane Rizvanolli, MSc – hulumtuese e lartë
Gent Beqiri, BSc – hulumtues
Saxhide Mustafa, BSc – hulumtuese
Albana Gashi, BSc – hulumtuese

Konsulent:

Profesor Iraj Hashi,
(Universiteti Staffordshire, Mbretëria e Bashkuar)



**Ky Projekt është mbështetur edhe nga tri banka kosovare:
TEB Bank, ProCredit Bank, Banka Ekonomike.**

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	4
REKOMANDIMET.....	6
1. Hyrje.....	7
2. Qeverisja korporative e institucioneve financiare.....	9
2.1.Dëshmi lidhur me çështje të qeverisjes korporative në institucionet financiare.....	9
2.2.Qeverisja korporative në institucionet financiare dhe karakteristikat specifike të tyre	11
2.3.Një Përmbledhje e shkurtër e Industrisë së bankave dhe sigurimeve në Kosovë..	12
2.3.1. Bankat komerciale.....	12
2.3.2. Sektori i sigurimeve.....	16
3. Korniza ligjore dhe rregullative për sektorin bankar dhe të sigurimeve	18
3.1.Dispozitat ligjore për sektorin bankar në Kosovë	18
3.2.Dispozitat ligjore për sektorin e sigurimeve në Kosovë	19
4. Gjendja e tanishme e qeverisjes korporative në banka dhe kompani të sigurimit – rezultatet e anketës.....	22
4.1.Të drejtat e aksionarëve dhe funksionet kyçe të pronësisë	22
4.2.Trajtimi i barabartë i aksionarëve	24
4.3.Roli i palëve të interesuara në qeverisjen korporative	26
4.4.Bërja publike dhe transparenca.....	28
4.5.Përgjegjësitë e Bordit	31
Referencat.....	34

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Një sistem efektiv i qeverisjes korporative në banka dhe kompani të sigurimit mundëson vendosjen e standardeve adekuate të sjelljes për menaxherët dhe procedura të kontrollit dhe monitorimit të bankave me qëllim të maksimizimit të mundësive për gjenerim të fitimit në interes të depozituesve dhe aksionarëve. Qeverisja e mirë korporative rregullon marrëdhëniet ndërmjet palëve të interesuara të bankave, bordeve dhe menaxhmenteve të tyre. Parandalon abuzimet dhe sjelljet vetjake si dhe jo të shëndosha e rreziksjellëse të menaxherëve të bankave, si dhe zbut konfliktin e interesit ndërmjet menaxherëve dhe anëtarëve të bordeve në njërin anë, si dhe aksionarëve dhe depozituesve në anën tjetër. Dhe vërtet, gjendja aktuale e ekonomisë botërore mund t'i atribuohet deri diku faktit se bordet dhe komitetet e tyre për menaxhim të rrezikut, nuk kanë bërë sa duhet për të ushtruar mbikëqyrje efikase të menaxherëve të cilët mund të sharrojnë në aktivitete të rrezikshme. Qeverisja korporative e sektorit financiar rrjedhimisht ka implikime serioze në stabilitetin e tërë ekonomisë.

Sistemi bankar dhe i sigurimeve në Kosovë është relativisht i ri, i themeluar menjëherë pas luftës së vitit 1999 (banka e parë u themelua pas vitit 2000). Që nga atëherë, bankat i kanë zgjeruar aktivitetet e tyre çdo vit, dhe i kanë rritur depozitat e asetet si dhe kreditë ndaj bizneseve dhe ekonomive familjare. Depozitat kanë arritur vlerën 1.42 miliard euro në janar 2009, që paraqet një rritje prej 23.3% krahasuar me një vit më parë, kurse kreditë, po në janar 2009, kanë arritur vlerën 1.189 miliard euro, që paraqet një rritje prej 31.7% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Matur sipas treguesve të profitabilitetit ROE dhe ROA, sistemi bankar i Kosovës tregon performansën më të mirë në rajon duke u karakterizuar me një rritje konstante të fitimit. Por, sistemi bankar i Kosovës është tejet i koncentruar në tri bankat më të mëdha kosovare, i cili shprehet në masën 90% të asetëve, 88% të depozitave dhe 81.5% të kredive. Sektorët e bankave dhe të kompanive të sigurimit janë treguar mjaft atraktivë për investimet e huaja direkte, ku 6 nga 8 bankat ekzistuese dominohen nga kapitali i huaj.

Është e pritshme që transparenca dhe qeverisja e konsoliduar korporative të ndikojnë pozitivisht në zhvillimin e sektorit financiar në Kosovë që do të kishte ndikim edhe në uljen e ekonomisë joformale duke kanalizuar më mirë qarkullimin e parasë dhe të transaksioneve të tjera financiare, por edhe duke ndihmuar zhvillimin e segmenteve të tjera të tregjeve të kapitalit, siç është për shembull tregu i kapitalit aksionar.

Duke krahasuar dhe vënë në peshojë rregullat dhe rregulloret për funksionimin e sistemit bankar të Kosovës kundruall parimeve të OECD-së për qeverisje korporative, mund të vërehet se shumica e rregulloreve adresojnë raportimin financiar dhe bërjen publike, gjëra që korrespondojnë me parimin e pestë të OECD-së – bërja publike dhe transparenca. Rregullat dhe rregulloret e bërjes publike dhe transparencës vetëm në mënyrë marginale mbulojnë çështjet e ndërlidhura me parimin e parë (sigurimi i bazës për një kornizë efektive të qeverisjes korporative), dhe parimit të dytë (të drejtat e aksionarëve) Parimi i katërt i OECD-së (të drejtat e palëve të interesuara) nuk është i adresuar në mënyrë meritore në Rregullin e plotësuar VIII, ku të drejtat e depozituesve (por jo edhe të palëve të tjera) janë përmendur. Rregullat dhe rregulloret nuk kanë adresuar parimin e tretë të OECD-së (trajtimi i barabartë i të gjithë aksionarëve). Duket se bankat injorojnë klauzolën që kërkon që së paku dy (nga pesë) anëtarët e Bordit të jenë anëtarë joekzekutivë (apo të pavarur). Mungesa e drejtorëve të pavarur në Bord prek ndjeshëm rolin mbikëqyrës të Bordit dhe u mundëson menaxherëve dhe anëtarëve të Bordit të çojnë përpara interesat personale.

Si përmbledhje, korniza ligjore dhe rregulluese mbi funksionimin e bankave dhe kompanive të sigurimit në Kosovë, ka qenë në fuqi për një kohë relativisht të gjatë, që nga viti 2000. Por, pjesa e 'legjislacionit' që ka të bëjë me qeverisjen korporative është relativisht e mangët. Megjithatë, është e rëndësishme të spikatet fakti se një vëmendje e madhe i është kushtuar transparencës së këtyre institucioneve. Kriteri i përmbushjes së normave etike, profesionale dhe integritetit personal për aksionarët e mëdhenj dhe menaxherët e lartë si dhe nëpunësit e tjerë në industrinë e sigurimeve, është një hap që siguron ndërtimin e besimit në sistem dhe për të siguruar se kualiteti i faktorit njeri është një çështje e çmueshme për autoritetin rregullator.

Rezultatet tona të hulumtimit japin të kuptojnë se aksionarët janë të informuar me kohë dhe në mënyrë adekuate. Po ashtu ka indikacione se të drejtat e aksionarëve respektohen dhe se ata kanë mundësi të ushtrojnë funksionet e tyre kyçe. Megjithatë, nuk ekziston kërkesë formale për mbrojtjen e aksionarëve të vegjël, edhe pse kjo nuk është çështje akute në sistemin financiar të Kosovës për shkak të ekzistimit të një numri të vogël aksionarësh.

Çështja e palëve të interesuara të industrive bankare dhe të sigurimit nuk është e rregulluar në Kosovë, prandaj, mbetet në vetë bankat dhe kompanitë e sigurimit të adresojnë këtë aspekt. Kjo ka rezultuar në situatën ku palët e interesuara trajtohen kryesisht vetëm në kuadër të marrëdhënieve me publikun. Hulumtimi reflekton mungesën e kërkesës ligjore për adresimin e interesave të palëve të interesuara – veçanërisht për të punësuarit dhe depozituesit.

Në anën tjetër, është perceptimi i njëjës nga palët e interesuara të industrive të bankave dhe të kompanive të sigurimit – komunitetit të biznesit, që kushtet e kreditimit janë të pafavorshme dhe joadekuate për zgjerimin e biznesit, gjë që paraqet çështje kyçe për një rritje të qëndrueshme ekonomike dhe adresimin e problemeve të thella socio-ekonomike në Kosovë – papunësinë dhe varfërinë. Kosova ka normat më të larta kredituese në rajon, intensitetin më të ulët të kredisë (pjesëmarrja e kredive në GDP), dhe performansë shumë të mirë të sistemit bankar matur sipas treguesit ROE dhe sipas rritjes së profitit. Qeveria duhet të marrë masa për të nxitur më shumë konkurrencë në sektorin financiar, dhe të ndërmarrë veprime për të përmirësuar kredidhënien për sektorin privat. Interes i përbashkët i të gjithë akterëve është rritja më e madhe ekonomike dhe marrja me kohë e masave parandaluese për zbutjen e reflektimeve potenciale të krizës së tanishme globale. Në këtë drejtim, ka mjaft çfarë të bëhet.

Rekomandimet

1. Nisur nga rëndësia e veçantë e këtyre sektorëve për funksionimin e ekonomisë dhe jetës së qytetarëve, Kuvendi, Qeveria dhe BQK-ja, duhet të nisin kryerjen e shqyrtimit të legjislacionit që e rregullon këtë sektor, me synim të adoptimit të një ligji specifik për banka dhe kompani të sigurimit, që do të ishte i përshtatshëm për nivelin aktual të zhvillimit të ekonomisë vendore. Brenda kësaj kornize ligjore, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet përmirësimit apo avancimit të përvojave në qeverisjen korporative të institucioneve financiare dhe parimeve të Organizatës për Zhvillim dhe Bashkëpunim Evropian (OECD) në këtë fushë. Bazuar në rezultatet e hulumtimit tonë, ne rekomandojmë si në vijim:
 - a. Formulimi i rregullimit të përbërjes së Bordit të drejtorëve në mënyrë më efikase, me qëllim për të siguruar prezencën e drejtorëve të pavarur;
 - b. Sigurimi që konfliktet e interesit në të dy nivelet, si në atë të nivelit të Bordit dhe atë të nivelit operativ të zgjidhen në mënyrë të duhur;
 - c. Qartësimi më i mirë i rolit të palëve të interesuara dhe ndërmarrja e hapave për të siguruar involvimin e palëve kryesore të interesuara: depozituesit, huamarrësit, të siguruarit, komuniteti dhe të punësuarit;
 - d. Shqyrtimi i mundësive për krijimin e Ligjit për sigurimin e depozitave, duke u bazuar në përvojat aktuale të vendeve të tjera si pasojë e krizës financiare globale;
2. Bankat dhe kompanitë e sigurimit brenda politikave dhe procedurave të tyre, duhet të adoptojnë formalisht parimet e OECD-së për qeverisje korporative dhe të raportojnë për zbatimin e tyre në raportet e tyre vjetore.
3. Bankat dhe kompanitë e sigurimit duhet të avancojnë politikat e tyre të qeverisjes korporative për caktimin e anëtarëve të pavarur të bordeve, marrëdhënie më të mira me palët e tyre të interesuara dhe për themelimin e sistemit unitar të Bordit në përputhje me kërkesat ligjore.
4. Bankat dhe kompanitë e sigurimeve duhet të zhvillojnë programe trajnimi për personelin e tyre menaxherial si dhe për anëtarët e bordeve me qëllim të përmirësimit dhe avancimit të praktikave të tyre të qeverisjes korporative nga perspektiva e parimeve të¹ OECD-së.

¹ Një kërkesë e tillë ligjore në Kosovë ekziston në kuadër të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike që parasheh trajnimin e anëtarve të bordeve një herë në vit.

1. HYRJE

Ky raport hulumtues përmban analizat dhe vlerësimet për kualitetin e qeverisjes korporative në institucionet financiare (bankat dhe kompanitë e sigurimeve) në Kosovë, duke u bazuar në kërkesat dhe standardet e njohura si parimet e Organizatës për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik (OECD). Qëllimi i këtij raporti është që të përmirësojë informacionin për akterët relevantë lidhur me të arriturat dhe situatën sa i përket qeverisjes korporative nëpër banka dhe kompani të sigurimeve, si dhe të bëjë rekomandime për politika të ndryshme për Qeverinë, BQK-në (Bankën Qendrore të Kosovës), si dhe për kompanitë e sektorit financiar dhe palët e tjera me interes për avancimin e mëtejshëm të gjendjes në këtë fushë. Raporti është komponenti i tretë i projektit “Përmirësimi i Kornizës së Qeverisjes Korporative dhe Transparencës në Kosovë”, që është i fokusuar në sektorin financiar, respektivisht në banka dhe kompani të sigurimit².

Komponenti i parë i projektit kishte të bëjë me analizimin e gjendjes aktuale të qeverisjes korporative në ndërmarrjet publike (sidomos KEK dhe PTK), nëpërmjet raporteve vazhduese dhe diskutimeve në arritjet e bëra prej vitit 2006. Ndërsa komponenti i dytë i këtij projekti ka qenë i fokusuar në programet e trajnimit në çështjet e qeverisjes korporative dhe transparencës, i mbajtur në dy cikle për diku rreth 100 pjesëmarrës, përfshirë këtu edhe anëtarët e bordeve dhe të menaxhmentit të bankave, kompanive të sigurimit, ndërmarrjeve publike, mediave, qeverisë, ministrive dhe agjencive rregullative.

Projekti është financuar nga Qendra për Ndërmarrje Private Ndërkombëtare (CIPE) Washington D.C. dhe është implementuar nga Instituti për Hulumtime Zhvillimore – Riinvest. Projekti, po ashtu, është përkrahur edhe nga tri banka kosovare, TEB, ProCredit dhe Banka Ekonomike. Analizat e qeverisjes korporative të institucioneve financiare në këtë raport janë bërë duke u bazuar në perspektivat e Parimeve dhe Udhëzimeve për Qeverisje Korporative të OECD-së, si dhe në standardet dhe rregullat e tjera ndërkombëtare të qeverisjes korporative të mirë dhe transparencës së mirë.

Gjatë përgatitjes së këtij raporti hulumtues, ekipi i projektit ka bërë studimin e raporteve të ndryshme të bankave dhe kompanive të sigurimit, siç janë raportet e Bankës Qendrore të Kosovës, raportet vjetore të bankave dhe kompanive të sigurimit, si dhe literaturat e tjera që mbulojnë këtë fushë. Angazhimi kryesor i hulumtimit ishte fokusuar në një anketë gjithëpërfshirëse të institucioneve financiare, duke përfshirë aspekte të ndryshme të praktikave të qeverisjes korporative të tyre dhe identifikimin e përmbushjeve të parimeve të tyre të OECD-së. Intervistat janë kryer direkt sy më sy me anëtarët e Bordit dhe menaxhmentin e pothuajse të të gjitha bankave, si dhe me shumicën e kompanive të sigurimit në Kosovë, gjithashtu edhe me palët e tjera të interesit, si Shoqata e Bankave dhe Kompanive të Sigurimit, Oda Ekonomike e Kosovës dhe Aleanca Kosovare e Biznesit. Pyetëtori i gjysmëstrukturuar që ka përmbajtur pyetje specifike dhe me pyetje të hapura është kompletuar për çdo individ të intervistuar.

² Ky projekt përfaqëson fazën e dytë të bashkëpunimit në mes të CIPE-s dhe Institutit Riinvest. Projekti ka vazhduar nga faza e parë e projektit që ishte fokusuar në qështjet e Qeverisjes korporative të ndërmarrjeve publike (POEs), respektivisht KEK-ut dhe PTK-së, që është implementuar në vitin 2006.

Ky raport hulumtues është përgatitur që të prezantohet dhe të diskutohet në një konferencë ndërkombëtare që është mbajtur më 8 prill 2009, që ka përfaqësuar aktivitetin final të këtij projekti. Struktura e raportit hulumtues është e dizajnuar si në vijim. Në pjesën e parë, raporti paraqet "Përmbledhjen ekzekutive dhe rekomandimet", pasuar nga "Hyrja". Seksioni 2 diskuton rëndësinë e qeverisjes korporative të institucioneve financiare dhe hollësitë e tyre specifike. Seksioni 3 vazhdon me analizat e kornizave rregulluese dhe ligjore në Kosovë. Seksioni 4 prezanton rezultatet e anketës në lidhje me gjendjen aktuale të qeverisjes korporative në banka dhe industri të sigurimit.

Ne dëshirojmë që të falënderojmë organizatën CIPE për financimin e këtij projekti dhe gjithashtu edhe për mbështetjen e vazhdueshme gjatë implementimit të tij. Ne gjithashtu dëshirojmë që të falënderojmë edhe TEB-in, ProCredit Bankën, dhe Bankën Ekonomike për pjesëmarrjen e tyre në mbështetjen e disa aktiviteteve të projektit. Falënderimet tona i shkojnë po ashtu edhe profesor Iraj Hashit për një bashkëpunim të shkëlqyeshëm me ekipin e projektit tonë. Rezultatet dhe opinionet e prezantuara në këtë raport përfaqësojnë mendimet dhe pozicionet e Institutit Riinvest dhe nuk do të thotë se domosdo përfaqësojnë mendimet apo pozicionet e palëve të tjera që janë përfshirë gjatë realizimit të këtij projekti.

2. QEVERISJA KORPORATIVE E INSTITUCIONEVE FINANCIARE

2.1. Dëshmi lidhur me çështje të qeverisjes korporative në institucionet financiare

Natyra komplekse e financave do të thotë se konceptet dhe aktivitetet ditore të institucioneve financiare nuk mund të kuptohen lehtë nga shumica e popullsisë, për këtë arsye ata duhet të mbështeten të tjerët (bankierët) për informata, që e bën ‘besimin’ element thelbësor për funksionim të mirë të sistemeve financiare, dhe është ‘besimi’ ai që i dallon institucionet financiare nga ato jofinanciare (Trayler, 2007).

Nëse besimi konsiderohet si arsye e parë, atëherë rëndësia që institucionet financiare e kanë për stabilitetin e gjithmbarshëm të shtetit mund të konsiderohet arsye e dytë që i dallon institucionet financiare nga ndërmarrjet e tjera. Ky fakt ka ndikuar që shumica e qeverive ta rregullojnë³ sektorin financiar. Është vështirë të gjendet ndonjë shtet që e ka të parregulluar industrinë financiare.⁴

Dallimet në mënyrën e implementimit të rregullave si dhe dallimet në menaxhimin e riskut konsiderohen si elementet kryesore që kanë kontribuar në dallimin e bankave evropiane në dritën e krizës së fundit financiare. Derisa dy bankat më të mëdha në Spanjë kanë deklaruar € 14 bilionë profit për vitin paraprak, tri banka belge kanë shpallur humbje që e tejkalojnë mjaft shumë këtë shifër. Mbikëqyrësi spanjoll i bankave, siç duket ka mësuar nga kriza bankare e vitit 1977 dhe ka vendosur kriteret më të rrepta për bankat lokale lidhur me kërkesat për kapital, kriteret që nuk janë të zakonshme për bankat evropiane. Për më tepër, gjatë viteve të suksesshme, bankat duhet të ndajnë më shumë rezerva për kreditë e këqija. Kjo qasje siç duket ka funksionuar deri në krizën e fundit (Lannoo, 2009).

Këto janë arsyet kryesore pse disa hulumtues thonë që ka dallim të madh mes qeverisjes korporative dhe ndërmarrjeve të tjera dhe qeverisja korporative e institucioneve financiare duhet të studiohet veçmas.⁵

Caprio dhe Levine (2002) përmendin karakteristikat e veçanta të bankave dhe institucioneve të tjera financiare që e intensifikojnë problemin e qeverisjes korporative. Ata i identifikojnë tri karakteristika të bankave që i bënë ato të ndryshojnë nga ndërmarrjet e tjera. Së pari, bankat janë të komplikuar, cilësi që e intensifikon problemin “punëdhënës – agjent”. Komplikueshmëria në banka e bën (i) më të vështirë për aksionarët t’i monitorojnë menaxherët, (ii) më lehtë për menaxherët dhe investitorët e mëdhenj t’i vjelin përfitimet e kontrollit, në vend se të maksimizojnë vlerën e kompanisë⁶, (iii) relativisht të pamundur për ofertuesit e jashtëm që të krijojnë një kërcënim të besueshëm për blerje, dhe (iv) që të rriten gjasat që një sektor më monopolist të pasojë dhe do të zvogëlojë efektin e mekanizmave të qeverisjes korporative përmes konkurrencës.⁷

Së dyti, bankat janë të shumë rregulluara dhe kjo shpesh imponon pengesë natyrale për mekanizmat e qeverisjes korporative. Masat, si sigurimi i depozitave,

³ Rregullimi perceptohet si pengesë meqë disa pohojnë se ka fërkim mes rregullimit të bankave dhe qeverisjes korporative qysh nga ditët e para të bankave moderne (Shull, 2007).

⁴ Niveli i rregullimit është specifik për secilin shtet madje edhe për shtetet brenda BE-së.

⁵ Ka studiues që pohojnë se ka dallime të rëndësishme mes bankave dhe institucioneve të tjera financiare (p.sh. fondet e përbashkëta në tregjet financiare, kompanitë jobankare të kredit kartelave etj.) në këtë mënyrë duke avokuar për studim të veçantë të Qeverisjes korporative të bankave. (për më shumë, shih Macey and O’Hara 2003).

⁶ Investitorët e mëdhenj dhe menaxherët mund ta manipulojnë ndërmarrjen që të veprojnë në interes të tyre në vend të interesave të Bordit të korporatës dhe aksionarëve të tjerë.

⁷ Asimetria e informatës që e përcjell industrinë bankiere e bën shumë të shtrenjtë për ofertuesit e jashtëm që të mbledhin informatat e domosdoshme që të prodhojnë rrezik të mjaftueshëm për blerje, që u lejon menaxherëve më shumë diskrecion në ndjekjen e interesave të tyre pa u brengosur shumë se mund të zëvendësohen si pasojë e ndonjë shitblerjeje të dhunshme.

restriksionet e vendosura nga rregullatorët lidhur me koncentrimin e pronës, restriksionet nga rregullatorët për hyrje në treg, blerje, aktivitete bankiere etj., të gjitha kanë efekte të padëshiruara në mekanizmat e dizajnuara nga aksionarët për ta kontrolluar menaxhmentin. Kufizimi i numrit të aksioneve për një pronar dhe ndalimi i blerjeve të dhunshme, dobëson mekanizmat e qeverisjes korporative, për shkak të rregullimit dhe komplikimit të bankave, pohon Levine (2003). E treta, siç sugjerojnë Caprio dhe Levine (2002), pronësia shtetërore e bën qeverisjen korporative të industrisë bankiere shumë të ndryshme nga industritë e tjera. Pronësia shtetërore e bankave mbetet e lartë në shumë vende dhe kjo paraqet problem për qeverisje korporative, meqë krijon situatë të konfliktit të interesit mes shtetit si ‘autoritet monitorues’ dhe ‘autoritet rregullator’. Pronësia shtetërore e bankave gjithashtu nënkupton që menaxhimi i bankës u dorëzohet burokratëve të cilët vështirë se do ta maksimizojnë vlerën e saj, por më me gjasë do t’u shërbejnë grupeve të veçanta të interesit.

Macey dhe O’Hara (2003) identifikojnë katër elemente që i dallojnë bankat nga ndërmarrjet e tjera. Së pari, është roli i bankave në likuiditetin e prodhimit që shpjegohet përmes strukturës së kapitalit të bankave që është unik në dy aspekte. i) Bankat zakonisht kanë pak kapital në krahasim me ndërmarrjet e tjera, dhe ii) obligimet e bankës kanë formën e depozitave, të cilat janë në dispozicion të depozituesve sipas kërkesës, përderisa mjetet e bankës janë kreditë të cilat mesatarisht kanë afat më të gjatë të maturitetit (sesa obligimet). Mospërputhshmëria mes obligimeve dhe mjeteve të bankës mund të shndërrohet në problem me implikime për qeverisjen korporative në situatën e jashtëzakonshme të “shterjes së bankës”⁸. Teorikisht, shterja e bankës mund t’u ndodhë edhe bankave solvente. Me qëllim të zbutjes së këtij problemi, Fondi federal i sigurimit të depozitave u krijua, fond i cili sipas Macey dhe O’Hara është pika e dytë e dallimit mes qeverisjes korporative të bankave dhe ndërmarrjeve të tjera. Fondi federal i sigurimit të depozitave (FDIC)⁹ u tregua shumë i suksesshëm në parandalimin e panikut bankar. Sidoqoftë, kostoja rregulluese e sigurimit të depozitave është se i stimulon menaxherët dhe aksionarët e bankave të siguruara të ndërmarrin rreziqe të mëdha. Rreziku moral mundet lehtë të paraqitet meqë aksionarët e bankave mund ta bartin një pjesë të humbjeve të tyre te bankat e shëndosha, kontributet e të cilave në FDIC i paguajnë depozituesit e bankave të dështuara, ose në fund taksapaguesit të cilët i rimbushin fondet e sigurimit federal nëse ato janë shterur.

Dallimi i tretë i potencuar nga Macey and O’Hara është konflikti mes paditësve dhe aksionarëve.¹⁰ Çka i bënë bankat të ndryshme nga llojet e tjera të ndërmarrjeve, është mungesa e disiplinës që imponohet nga paditësit e tjerë. Ekzistimi i FDIC i largon stimulimet që depozituesit e siguruar të kontrollojnë predispozimin e madh ndaj rrezikut, meqë fondet e tyre janë të sigurta pa marrë parasysh strategjitë investuese të zgjedhura nga bankat.

⁸ “Shterja e bankës” është problem i veprimit kolektiv mes depozituesve. Nëse, për çfarëdo arsye, fillojnë tërheqje të mëdha nga banka, depozituesit si individ, nga frika se mund të mesin pa asgjë nëse rezervat shterojnë, fillojnë t’i tërheqin depozitat e tyre (Diamond and Dybvig 1983). Kjo është situatë klasike e dilemës së të burgosurit, ku depozituesit do të ishin në situatë më të mirë sikur të përmbaheshin nga tërheqja e depozitave. Mirëpo, për shkak të paaftësisë së tyre që t’i koordinojnë aksionet e tyre, ata e shkaktojnë shterjen e bankës. Një nga shembujt e freskët është The Northern Rock Bank e cila ishte gati viktimë e shterjes së bankës gjatë verës së vitit 2008.

⁹ Akti Bankar u aprovua nga Kongresi i SHBA-së në vitin 1933 duke e krijuar Korporatën për Sigurimin e Depozitave (FDIC) dhe i dha Qeverisë federale që t’i sigurojë depozitat në bankat e kualifikuara.

¹⁰ Nëse korporata vështrohet si një numër i kontratave eksplicite dhe implicite, ka lloje të ndryshme paditësish për rrjedhën e parasë së korporatës. Paditësit përfshijnë përveç aksionarëve edhe kredituesit, punëtorët, menaxherët, komunitetet lokale ku ndërmarrja operon, furnizuesit, dhe konsumatorët. Paditësit gjithashtu përfshijnë rregullatorët në rolin e tyre si siguruues të depozitave dhe huadhënës si opion i fundit dhe në rolin e tyre si agentë të paditësve tjerë.

Dallimi i katërt është struktura e mjeteve dhe problemet me lojalitet. Meqë ekzistimi i FDIC i zvogëlon stimulimet për monitorim, natyrisht e rrit rrezikun për mashtrim dhe përfitime personale. Depozituesit nuk kanë stimulim që ta monitorojnë menaxhmentin për shkak të problemit “free-rider”, dhe ata shumë rrallë organizohen për arsye të problemit të veprimit kolektiv. Për këtë arsye, nën Aktin Federal për Sigurim të Depozitave, nga agjencitë rregullatore kërkohet që të publikojnë këshilla ose rregulla që do të krijojnë standarde për siguri dhe qëndrueshmëri në shumë fusha si: kontrolli i brendshëm, dokumentimi i huave, dhënia e kredive, ekspozimi i normës së interesit, rritja e mjeteve, kompensimi, cilësia e mjeteve etj.

Si përmbledhje, literatura tregon se ka argumente të forta në favor të dallueshmërisë së qeverisjes korporative të institucioneve financiare (kryesisht bankave) dhe ndërmarrjeve të tjera. Dallimet rrjedhin nga natyra e ndjeshme dhe e komplikuar e afarizmit të këtyre ndërmarrjeve ku “besimi” është faktor thelbësor për funksionimin e tyre. Gjithashtu janë edhe efektet sistemike për ekonominë në rast se gjërat shkojnë keq për ndonjërin nga këto institucione. Ky ka qenë arsyetimi për rregullim më të ashpër të këtyre institucioneve nga qeveritë. Dallimet e tjera si: bordet më të mëdha, takimet më të shpeshta të bordeve dhe niveli më i lartë i përgjegjësisë për drejtorët dhe zyrtarët konfirmojnë se me të vërtetë ekziston dallim në qeverisje korporative të institucioneve financiare në krahasim me ndërmarrjet e tjera.

2.2. Qeverisja korporative në institucionet financiare dhe karakteristikat specifike të tyre

Avancimi i parimeve të qeverisjes korporative në sektorin financiar është kritike për të nxitur përmirësimet e ambientit biznesor. Në një treg të sapo dalë si ekonomia e Kosovës, sektori financiar luan një rol të rëndësishëm, duke orientuar kursimet shoqërore në investime dhe duke i ofruar kredi të domosdoshme sektorit privat (si ndërmarrjeve po ashtu edhe familjeve). Stabiliteti dhe rritja e qëndrueshme ekonomike janë ngushtë të lidhura me stabilitetin e sektorit financiar (sidomos të sistemit bankar) dhe çdo tronditje ndaj sektorit financiar është e mundur të shkaktojë paqëndrueshmëri serioze në tërë ekonominë. Kjo është shumë e vërtetë sidomos kur kemi parasysh krizën e fundit të ekonomisë botërore. Sektori financiar vuan nga informatat asimetrike apo të njëanshme (si p.sh. ndërmjet menaxherëve të bankave dhe depozituesve; dhe ndërmjet bankave dhe rregullatorëve) që mund të jenë edhe më të theksuara nga mungesa e transparencës dhe bërja publike e informacioneve – një problem që është shumë i zakonshëm në Kosovë.

Në një sistem të dobët të qeverisjes korporative, këto informata të njëanshme apo asimetrike janë në gjendje të minojnë stabilitetin e sistemit bankar, duke rezultuar në humbje të besimit dhe rrezikimin e tërheqjes së depozitave nga bankat, ose duke rezultuar në një shtrëngim të procedurave dhe mos lëshim të kredive që do të kishte efekt në sektorin e bizneseve dhe të familjeve.

Në fakt, gjendja aktuale e ekonomisë botërore i atribuohet deri diku faktit se bordet (dhe komitetet e tyre të rrezikut) nuk i kanë realizuar detyrat e tyre në mënyrë adekuate për të ushtruar mbikëqyrjen e menaxherëve të cilët mund të involvohen në aktivitete të rrezikshme. Prandaj, qeverisja korporative e sektorit financiar ka implikime serioze për stabilitetin e ekonomisë botërore.

Pritet që qeverisja e përforcuar korporative dhe transparenca e sektorit financiar do të ndikojë pozitivisht në zhvillimin e sektorit financiar në Kosovë që gjithashtu do të ketë ndikim në reduktimin e ekonomisë joformale nëpërmjet kanalizimit më të mirë të qarkullimit të parasë dhe transaksioneve të tjera financiare, dhe gjithashtu do të ndihmonte zhvillimin edhe të segmenteve të tjera të tregjeve të kapitalit, si për shembull tregun e kapitalit aksionar.

Një sistem efektiv i Qeverisjes korporative në banka dhe kompani të sigurimit mundëson vendosjen e standardeve adekuate të sjelljes për menaxherët dhe procedura të kontrollit dhe monitorimit të bankave me qëllim të maksimizimit të mundësive për gjenerim të fitimit në interes të depozituesve dhe aksionarëve. Qeverisja e mirë korporative rregullon marrëdhëniet ndërmjet aksionarëve të bankës dhe depozituesve, bordeve dhe menaxhmenteve të tyre dhe gjithashtu parandalon abuzimin dhe sjelljet vetjake e të rrezikshme nga menaxherët e bankës, si dhe zgjidh konfliktet mes interesave private dhe zyrtare.

2.3. Një përmbledhje e shkurtër e Industrisë së Bankave dhe Sigurimeve në Kosovë

Institucionet financiare në Kosovë janë të licencuara dhe mbikëqyren nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK-ja). BQK-ja i raporton Parlamentit dhe e këshillon Qeverinë. Sektori financiar përfshin industrinë e bankave, industrinë e sigurimit, fondet e sigurimit dhe institucionet e tjera financiare, si skemat e mikrokredive. Numri total i institucioneve financiare arriti në 66 në fund të vitit 2008, ku 8 prej tyre janë banka, 10 janë kompani të sigurimeve, ndërsa të tjerat përfshijnë kryesisht institucione ndërmjetëse mikrofinanciare.

2.3.1. Bankat komerciale

Sektori bankar në Kosovë është zhvilluar në mënyrë të shkëlqyeshme, dhe konsiderohet si një prej zhvillimeve më të suksesshme. Vlera e aseteve/obligimeve të sektorit financiar në Kosovë, në janar 2009 ishte 1.791 miliardë euro që krahasuar me vitin e kaluar, kemi një rritje prej 23.6 %. Prej vitit 2000, kur edhe është themeluar banka e parë komerciale pas konfliktit, vlera totale e aseteve të sektorit bankar është rritur për rreth 18 herë. Sektori financiar në Kosovë karakterizohet me një prezencë të madhe të kapitalit të huaj financiar. Kjo qëndron kryesisht në tregun e bankave dhe të sigurimeve, ku 91.0% të aseteve totale të bankave, dhe 72.1 % të aseteve totale të kompanive të sigurimeve janë të menaxhuara nga kompanitë e huaja. Prezenca e institucioneve të huaja financiare në Kosovë ka kontribuar në modernizimin e sistemit financiar duke sjellë me vete praktika të avancuara financiare në menaxhimin e operacioneve bankare dhe të sigurimeve. Momentalisht tetë (8) banka funksionojnë në Kosovë, ku gjashtë (6) prej tyre janë banka kryesisht me kapital të huaj.

Mirëpo, sektori bankar i Kosovës mbetet mjaft i koncentruar, ku 90 % e aseteve totale, 88 % e depozitave dhe 81.5 % e kredive në vitin 2008¹¹ janë të koncentruara në tri bankat më të mëdha në Kosovë. Niveli i depozitave në sektorin bankar është rritur prej viti në vit. Vlera e depozitave në janar të vitit 2009 arriti vlerën prej 1.422 miliardë euro, ku krahasuar me janar të vitit 2008 kemi një rritje prej 23.3 %. Ndërsa, vlera e depozitave në fund të vitit 2000 ishte 93 milionë euro, që do të thotë se niveli i depozitave prej vitit 2000 e deri në janar të vitit 2009 është rritur për 18 herë (shih tabelën në vijim). Pjesa më e madhe e depozitave (60 %) përbëhet nga depozitat familjare. Me rritjen e depozitave, aktiviteti i kredive vazhdimisht është rritur prej vitit 2000 e deri në vitin 2009. Vlera e kredive të lëshuara në treg, në janar të vitit 2009 ishte rreth 1.189 miliardë euro, ku krahasuar me të njëjtën periudhë paraprake, kreditë kanë shënuar një rritje prej rreth 31.7 %. Pjesa më e madhe e sektorit bankar të kredive i është lëshuar sektorit të tregtisë (76 % e kredive totale në janar të vitit 2009, respektivisht 77.7 % në janar të vitit 2008), përderisa rreth 24 % e kredive të tjera i janë lëshuar sektorit familjar, përqindje kjo e cila

¹¹ Koncentrimi i lartë në sektorin bankar gjithashtu paraqitet nga indeksi Herfindahl-Hirschman Index (HHI). Në vitin 2008 indeksi HHI për asete regjistroi 2,887 pikë krahasuar me 2,896 pikë në të njëjtën periudhë paraprake, përderisa indeksi HHI për kredi regjistroi 3,014 dhe për depozita regjistroi 3,016 pikë.

ende konsiderohet të jetë më e vogël sesa mesatarja e vendeve të regjionit. Kjo reflekton varshmërinë e madhe të ekonomisë së Kosovës në tregti.

Tabela 1: Shënimet e bankave (vlera në miliard euro)

Vitet	2000	2005	2006	2007	2008
Asetet/Obligimet	0.103	0.984	1.16	1.43	1.79
Depozitat	0.093	0.836	0.924	1.14	1.42
Kreditë	0.003	0.513	0.636	0.891	1.19

Burimi: Raportet vjetore të BQK-së 2001-2007, dhe raportet mujore.

Sektori bankar vazhdimisht është duke e rritur fitimin neto të tij. Vlera totale e fitimit neto të sektorit bankar në fund të vitit 2008 ishte rreth 36.4 milionë euro, duke e rritur fitimin prej rreth 7.7 % nga periudha paraprake, apo 173% krahasuar me fundin e vitit 2005 (13.5 milionë euro), respektivisht 185 % krahasuar me vitin 2004 (12.9 milionë euro).

Tabela 2: Të ardhurat dhe fitimi i bankave (vlerat në milion euro)

	2004	2005	2006	2007	2008
Të ardhurat totale të sektorit bankar	73.4	94.3	113.9	157.4	195.0
Të ardhurat totale nga norma e interesit të sektorit bankar	53.9	74.6	88.8	117.7	146.0
Fitimi neto	12.9	13.5	20.1	33.8	36.4
Norma e kthimit në asetet totale (ROTA) në %	1.6	1.5	1.9	2.6	2.5
Norma e kthimit në kapital të aksionarëve (ROE) në %	17.6	20.1	22.4	26.2	22.2

Burimi: Raportet vjetore të BQK-së

Të ardhurat e sektorit bankar janë kryesisht të bazuara në normat e interesit të kredive, ku pjesa e të ardhurave të sektorit bankar (146 milionë euro) në proporcion me të ardhurat totale të bankave në fund të vitit 2008 (195 milionë euro) ishte 74.9 %, pothuajse e njëjtë siç ishte në fund të vitit 2007 (74.8 %).

Norma e kthimit në asetet totale (ROTA) – Sektorit bankar vazhdimisht është duke e rritur normën e kthimit në asetet e tyre. Norma e kthimit në asetet totale (ROTA) në fund të vitit 2008 ishte rreth 2.5 %, përderisa në vitin 2007 ishte 2.6 %, në vitin 2006 ka qenë 1.9 %, krahasuar me vitin 2005 që ishte 20.1 %. Norma e kthimit në asetet totale (ROTA) është zvogëluar nga 2.6% që ishte në vitin 2007, në 2.5 % në vitin 2008. Ndërsa në vitin 2007 krahasuar me vitin 2006, niveli i kthimit/fitimit në asetet totale është zvogëluar për 70 pikë të përqindjes (siç është e cekur edhe në tabelën më lartë).

Norma e kthimit në kapitalin e aksionarëve (ROE) - Sektorit bankar vazhdimisht është duke e rritur normën e kthimit në ekuitetet e tyre. Norma e kthimit/fitimit (ROE) në vitin 2008 ishte 22.2 %, që ishte zvogëluar nga 26.2 % sa ishte në vitin 2007. Zvogëlimi i ROEs i atribuohet kryesisht rritjes më të shpejtë në kapitalin aksionar të sektorit bankar.

Pozicioni i likuiditetit të sektorit bankar të Kosovës (proporcioni ndërmjet kredive dhe depozitave) praktikisht veç ka kaluar kufizimet rregullative, e që pozicioni aktual i

likuiditetit në fund të vitit 2008 pothuajse ishte 82 %¹², që është në kundërshtim me rekomandimet e caktuara sipas rregullores së caktuar nga Banka Qendrore e Kosovës, ku në këtë formë edhe ul pozicionin e likuiditetit të sektorit bankar. Pozicioni i likuiditetit në vitin 2007 ishte rreth 78 % (brenda nivelit të rekomanduar nga BQK-ja), e që krahasuar me vitet paraprake, pozicioni i likuiditetit iu ofrua nivelit maksimal të rekomanduar nga BQK-ja (2006 ishte 69%, dhe në vitin 2004 ishte 54%).

Rritja e nivelit të depozitave dhe kredive tregon se sektori bankar i Kosovës është duke u zhvilluar edhe më tutje, dhe është duke e rritur rolin e tij në zhvillimin ekonomik. Kjo gjithashtu vërehet edhe nga rritjet e vazhdueshme të disa indikatorëve, si pjesëmarrja e aseteve të sektorit bankar në GDP, pjesëmarrja e depozitave në GDP, si dhe pjesëmarrja e kredive në GDP. Pjesëmarrja e aseteve në GDP në vitin 2008 është rritur në 47.5 %, krahasuar me 36.5 % sa ishte në vitin 2005. Kjo është kryesisht si shkak i rritjes në volumin e kredive që sektori bankar ka lëshuar në ekonomi, që në vitin 2008 ka arritur 31.1 % e GDP-së.

Tabela 3: Pjesëmarrja e kredive, depozitave dhe aseteve në GDP (në %)

Vitet	Kredi/GDP	Depozita/GDP	Asete/GDP	Kredi/Depozitat
2004	16.4	30.4	35.6	53.8
2005	16.8	27.4	32.2	61.4
2006	20.0	29.1	36.5	68.9
2007	26.1	33.4	41.8	78.1
2008	31.1	38.0	47.5	81.9

Burimi: Raportet vjetore dhe mujore të BQK-së

Norma e interesit – Mesatarja e përgjithshme e normave të interesit të kredive në vitin 2008 ishte rreth 15.1 %, krahasuar me 14.6 % sa ishin në vitin 2007. Tabela më poshtë gjithashtu tregon se mesatarisht niveli i normave të interesit gjatë viteve të kaluara ka qëndruar pothuajse i njëjtë me një ulje të vogël në vitin 2006 dhe rritje në vitin 2008.

Gjithashtu niveli i kredive është rritur prej viti në vit, përderisa normat e interesit kanë mbetur të larta, sidomos për nevojat afatgjata investuese të kapitalit, ndër më të lartat në rajon. Kjo posaçërisht vlen nëse e marrim parasysh edhe shtrirjen e normave të interesit (ndryshimi ndërmjet normave të interesit të kredive dhe depozitave), që edhe pse në përgjithësi këto shtrirje të normave të interesit po zvogëlohen, ato prapë janë ndër më të lartat në rajon. Gjithashtu edhe niveli i kredive dhe depozitave në sistemin bankar është rritur. Kjo gjithashtu paraqet se numri i bankave ka rezultuar në rritjen e konkurrencës në sektorin bankar, mirëpo vetëm për sa i përket normave të interesit më të favorshme për depozita, ndërsa norma e interesit të kredive vetëm sa është rritur.

Tabela 4: Normat e interesit¹³ të kredive dhe depozitave (në %)

	Vitet	2004	2005	2006	2007	2008
A	Depozitat	2.52	3.14	2.97	3.31	3.89
B	Kreditë	14.67	14.15	13.37	14.63	15.10
C	Shtrirja/ndryshimi i normave të interesit (C=A-B)	12.15	11.01	10.40	11.32	11.21


Burimi: Raportet vjetore të BQK-së 2007/6/5

¹² Margjina e rekomanduar nga Rregullatori (BQK-ja) është 70-80%.

¹³ Mesatarja e produkteve të ndryshme dhe maturiteteve.

Portofoli kreditor në sektorin bankar të Kosovës mbetet i kualitetit të mirë. Pavarësisht nga rritja e shpejtë e kredive, në shtator të vitit 2008, pjesëmarrja e kredive të këqija (NPLs) në proporcion me kreditë e përgjithshme (që përfshin këtu edhe kreditë e “dyshimta” dhe të “humbura”) u zvogëlua në 3.5 % krahasuar me 3.7 % sa ishte në vitin 2007 (shiko figurën më poshtë), e që rendit Kosovën nën mesataren prej 5.2 % të regjistruar në vendet e rajonit. Kjo sugjeron se portofoli kreditor i sektorit bankar në Kosovë, mesatarisht është i një kualiteti më të mirë sesa në vendet e tjera të rajonit. Megjithatë, duhet pasur kujdes, sepse në krahasim me vitin 2005 niveli i kredive të këqija është rritur për 2.5 herë, që tregon se kreditë e këqija janë gjithmonë në rritje, e sidomos në bankat e vogla.

Figura 1. Pjesëmarrja e kredive të këqija në proporcion me kreditë totale, (në %)



Burimi: Buletinet e BQK-së.

Krahasuar me grupet e bankave, bankat e mëdha po duket të kenë portofol kreditor të një kualiteti më të mirë sesa bankat e vogla. Në qershor të vitit 2008, niveli i kredive të këqija në proporcion me kreditë e përgjithshme në tri bankat më të mëdha është regjistruar në 3.2 %, përderisa ky nivel në bankat e tjera mesatarisht është regjistruar në 8.1 % të portofolit të tyre kreditor. Sa i përket analizës sipas sektorëve, niveli më i ulët i kredive të këqija është regjistruar te kreditë familjare.

Tabela 5. Indikatorët e linjave kreditore për vendet në tranzicion në vitin 2007 (në %)

	Sektori privat Kredi/GDP	Normat e interesit		Kreditë e këqija
		Depozitat	Kreditë (< 1 vit)	
Kosova	26.1	4.0	14.23	3.7
Shqipëria	41.2	6.0	13.6	3.4
Bosnjë e Hercegovina	46.0	n/a	n/a	3.0
Bullgaria	89.8	n/a	10.8	2.5
Serbia	47.5	4.1	11.0	n/a
Kroacia	117.7	2.7	9.3	4.8
Maqedonia	49.9	5.3	9.9	10.9
Mali i Zi	121.2	4.8	9.2	3.2

Burimi: EBRD Transition Report 2008, Vlerësimet e FMN-së së GDP-së për Kosovë dhe raportet vjetore të BQK-së.

Tabela më lart tregon se niveli më i ulët i kredive në proporcion me GDP-në është në Kosovë, që në krahasim me vendet e rajonit reflekton një nivel të ulët të kredive të lëshuara. Gjithashtu normat e interesit për kreditë deri në një vit tregojnë të jenë ndër më të lartat në rajon, që sugjerojnë se kreditë janë ndër më të shtrenjtat në rajon.

Në krahasim me vendet e rajonit, kjo tregon një ofertë të dobët të kreditit dhe një intensitet të ulët kreditor të shoqëruar me normat më të larta të interesit në rajon, ndërsa në anën tjetër, fitimet neto të bankave janë ndër më të mirat në rajon.

Tabela 6: Niveli i fitimeve

Vendet	2007	
	ROA	ROE
Kosova	2.4	21.5
Shqipëria	1.6	20.4
Serbia	1.7	8.5
Kroacia	1.6	10.9
Maqedonia	1.8	15.2

Burimi: Bankat qendrore të vendeve përkatëse

Rezultatet e prezantuara më lartë paraqesin një performansë financiare të shkëlqyeshme të bankave komerciale në Kosovë. Kjo është e dobishme sidomos duke e pasur parasysh situatën e krizës globale financiare që posaçërisht më së shumti ka goditur sistemet bankare. Megjithatë, duhet të ceket se në Kosovë kjo është arritur me intensitetin më të ulët kreditor (përpjesëtimi kredi/depozita), si dhe me normat më të larta të interesit dhe me margjinën apo ndryshimin më të lartë ndërmjet normave të interesit të depozitave dhe kredive.

Gjithashtu mund të argumentohet se kushtet e tregut të kredive kanë favorizuar këtë gjendje, mirëpo ende mbetet të analizohet nëse Qeveria e Kosovës dhe organet mbikëqyrëse kanë krijuar kushtet për një konkurrencë më të drejtë dhe më të madhe në tregun e kreditimit. Ende mbetet të analizohet se a janë duke marrë masat e domosdoshme për zvogëlimin e riskut, për të siguruar se a ka ofertë të mjaftueshme të kreditimit, apo nëse të gjitha bankave iu përshtaten kushtet aktuale në tregun e kreditimit.

Mund të pyesim se a është kjo gjendje e mirë dhe e përshtatshme për nevojat afatgjate zhvillimore të ekonomisë së Kosovës, në një situatë që është vështirë për bizneset t'i financojnë nevojat e tyre afatgjate zhvillimore. Në kushtet e qeverisjes korporative, pyetja mund të ngritet në fushën e pozicionit të pjesëmarrësve (depozitarëve, huamarrësve, qeverisë, organeve mbikëqyrëse, shoqërisë).

Një gjë është e qartë se në fund të fundit bankat dhe klientët, bizneset, dhe familjet kanë fatin e përbashkët dhe në këtë aspekt të gjithë duhet të jenë më të vetëdijësuar lidhur me faktin se të gjitha palët me interes duhet të kenë një bashkëpunim sa më të mirë.

2.3.2 Sektori i sigurimeve

Kompanitë e sigurimeve në Kosovë relativisht janë të vogla, me asete që në vitin 2007 kishin vlerën rreth 70.8 milionë euro. Nëse analizojmë vlerën e aseteve të industrisë

së sigurimeve, shohim se asetet e sektorit të sigurimeve në vitin 2007 në krahasim me vitin 2005, janë rritur për më shumë se 53 %, ku vlera e aseteve të sektorit të sigurimeve në vitin 2005 ishte 46.2 milionë euro). Në vitin 2007, pjesëmarrja totale e aseteve të kompanive të sigurimit në përpjesëtim me vlerën e përgjithshme të sektorit financiar ishte rreth 5%. Momentalisht janë nëntë (9) kompani të sigurimeve në Kosovë, ku gjashtë (6) prej tyre janë kompani me kapital të huaj, dhe tri (3) prej tyre janë kompani me kapital vendor. Aktiviteti kryesor i kompanive të sigurimit në Kosovë janë produktet si “Obligimet e palës së tretë (TPL)”, respektivisht sigurimet e automjeteve.

Këstet e përgjithshme të sigurimit arritën vlerën prej 50.8 milionë eurosh në vitin 2007, krahasuar me 48.7 milionë euro në vitin 2006, dhe 47.2 milionë eurove në vitin 2005. Pjesëmarrja e sigurimeve të produktit “Obligimet e palës së tretë (TPL)” në proporcion me shpërblimet e përgjithshme arriti nivelin prej 68.7% në vitin 2007. Vlera e kompensimeve të paguara nga kompanitë e sigurimeve në vitin 2007 ishte rreth 12.8 milionë euro, apo 25.2 % e totalit të sigurimeve (50.8 milionë euro në vitin 2007). Pjesëmarrja e produktit “Obligimet e palës së tretë (TPL)” në shpërblime apo kompensime, në proporcion me totalin e shpërblimeve të paguara nga kompanitë e sigurimeve ishte 84.8% në vitin 2007, krahasuar me 90% sa ishte në vitin 2006 dhe 96% sa ishte në vitin 2005. Vlera e kërkesave për kompensime nga kompanitë e sigurimeve në vitin 2006 ishte 10.9 milionë euro, krahasuar me 7.9 milionë euro sa ishte në vitin 2005.

3. KORNIZA LIGJORE DHE RREGULLATIVE PËR SEKTORIN BANKAR DHE TË SIGURIMEVE

Në këtë pjesë të këtij raporti shqyrtohet korniza ligjore dhe rregullative për banka dhe kompani të sigurimeve nga perspektiva e qeverisjes korporative. Në mungesë të ligjit specifik, funksionimi i Industrisë Bankare dhe i Sigurimeve rregullohet me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 1999/21 dhe 2001/25. Me kalimin e kohës, BPK (dhe trashëgimtari i saj BQK) kanë nxjerrë rregulla të reja dhe dokumente të tjera për të mbështetur dhe ndryshuar këto rregullore, të cilat vazhdojnë të mbesin bërthamë e kornizës rregulluese për industrinë bankare dhe të sigurimeve.

3.1 Dispozitat ligjore për sektorin bankar në Kosovë

Rregullorja Nr. 1999/21 mbi Licencimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Bankave është në fuqi që nga 15 nëntori i vitit 1999. Ky dokument përbëhet nga 53 pjesë që mbulojnë të gjitha fushat përkatëse, të përmendura në titull. Vetëm disa nga këto nene adresojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë qeverisjen e bankave ose çështje të tjera të lidhura me qeverisjen e mirë korporative.

Nenet 6.1 (a) dhe 6.1 (d) të ‘Pjesës 6 – Aplikimi për licencë’ nën titullin ‘Licencimi i bankave’ kërkojnë nga organi që aplikon për licencë bankare të ofrojë informacion të mjaftueshëm lidhur me kualifikimet dhe përvojën e administratorëve dhe personave që aplikojnë për të qenë aksionarë parësorë ose kanë interes të rëndësishëm në bankë, pasohen nga neni 7.2 (c) i cili kërkon nga BPK që të aprovojë kualifikimet, përvojën dhe integritetin e administratorëve dhe aksionarëve parësorë para se të japë licencën bankare. Për më tepër, Pjesa 18 kërkon që të gjithë personat e zgjedhur ose të emëruar si administratorë të bankës të jenë të përshtatshëm dhe me reputacion të mirë dhe të aprovohen nga BPK para se të marrin detyrën.

Sidoqoftë, ky nen nuk imponon ndonjë standard të matshëm të cilin duhet ta përmbushë personi që dëshiron të emërohet në këto pozita në një bankë të re (ose ekzistuese).

Neni 14.1 kërkon autorizim paraprak me shkrim nga BPK për transferimin e interesit të pronës në mes të aksionarëve të bankës për të parandaluar ndonjë person ose grup interesi që të shndërrohet në aksionar qenësor me pronësi të mbi 20 % të çfarëdo klase të aksioneve votuese të bankës.

Neni 17.1 thotë se secila bankë duhet të qeveriset nga Bordi qeverisës që përbëhet nga një numër tek anëtarësh (jo më pak se pesë), prej të cilëve dy do të jenë drejtorë joekzekutivë, si dhe duhet të ketë Komitetin e Auditimit, Komitetin e Menaxhimit të Rrezikut Kreditues dhe Komitetin e Menaxhimit të Aseteve dhe Obligimeve. Neni 17.2 thotë se Bordi qeverisës që zgjidhet nga aksionarët do të jetë përgjegjës për themelimin, mbikëqyrjen dhe implementimin e politikave, ndërsa neni 17.3 specifikon se Bordi qeverisës duhet të emërohet në Tubimin e përgjithshëm të aksionarëve.

Nenet 23.1 – 23.10 ofrojnë një spektër të gjerë këshillash dhe rregullash në lidhje me konfliktin e interesit për administratorët e bankës dhe punëtorët e tjerë të bankës, shpалosjen e informacionit dhe limitin e sipërm në proporcionin e kredisë së pasiguar.

Pjesa 30 i ndalon bankat të futen në aranzhime financiare me palë të ndërlidhura ose të punësuar në aso mënyre e cila do nënkuptonte kushte dhe terma më pak të favorshme për bankën. Asnjë bankë nuk do të japë kredi për ose në të mirë të një personi që është i lidhur me bankën përtej kufizimeve të vendosura nga BPK.

Pjesa 32 i udhëzon bankat që të përgatisin deklarata adekuate financiare vjetore për të paraqitur veprimtarinë e tyre dhe gjendjen financiare në pajtim me standardet

ndërkombëtare të kontabilitetit, si dhe për të paraqitur veprimtarinë dhe gjendjen financiare të degëve dhe filialeve, në bazë individuale edhe të konsoliduar.

Pjesa 33 jep kërkesa të qarta lidhur me rolin dhe obligimet e Komitetit të auditimit dhe auditorit të jashtëm si dhe të drejtat dhe obligimet e auditorit të brendshëm.

Pjesa 34 thotë se secila bankë duhet që brenda 30 ditëve të secilit 3 muaj të publikojë në një gazetë kombëtare një përmbledhje të saktë të bilancit kuartal si dhe brenda një afati katër muaj pas përfundimit të vitit financiar, të publikojë një përmbledhje të saktë të bilancit vjetor dhe opinionin e auditorit të saj për vitin e kaluar financiar. Secila bankë do të publikojë po ashtu raportin e saj vjetor dhe të shtypë kopje falas për publikun. Kjo pjesë është ndryshuar me Rregullën XXIV në shtator 2003.

Dhe në fund, duke krahasuar dhe kontraktuar rregullat dhe rregulloret e sistemit bankar në Kosovë me parimet e Qeverisjes Korporative të OECD-së (Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik) mund të vërehet se shumica e rregulloreve adresojnë raportimin dhe transparencën financiare që korrespondon me parimin e pestë të OECD lidhur me Shpalosjen dhe Transparencën. Një pjesë e arsyeshme e rregulloreve të shqyrtuara më lartë specifikojnë obligimet dhe përgjegjësitë e ekzekutivëve dhe aksionarëve kryesorë si dhe komiteteve të ndryshme, që krahasohet me parimin e gjashtë të OECD-së – përgjegjësitë e Bordit. Rregullat dhe rregulloret prekin fusha të mbuluara me parimin e parë (Sigurimi i bazës për një kornizë të qeverisjes korporative efektive) dhe parimin e dytë (të drejtat e aksionarëve) të OECD-së. Parimi i katërt i OECD-së (roli i aksionarëve) është adresuar në një mënyrë mjaft të paqartë në Rregullën e ndryshuar VIII, ku janë përmendur të drejtat e depozituesve. Sidoqoftë, lista e aksionarëve nuk mund të kufizohet vetëm në depozitues, sepse ka një numër të madh grupesh që janë aksionarë në një bankë (grupe si: punëtorët e bankës, klientët, komuniteti, etj). Ajo që rregullat dhe rregulloret e industrisë bankare nuk e adresojnë është parimi i tretë i OECD-së (Trajtimi i barabartë i aksionarëve) dhe ndoshta në të ardhmen ato duhet ta bëjnë këtë. Ndërsa një çështje tjetër për diskutim është dispozita, sipas të cilës në bordet qeverisëse drejtorët ekzekutivë mund të jenë shumicë (nga pesë, dy duhet të jenë joekzekutivë). Po ashtu, nuk ka asnjë dispozitë që obligon bordet të kenë anëtarë të pavarur. Struktura aktuale e bordeve qeverisëse në fakt pasqyron këto dispozita. Kjo do të mund të krijojë asimetri në praktikën qeverisëse dhe një mbipeshë të ndikimit të drejtorëve ekzekutivë.

3.2 Dispozitat ligjore për sektorin e sigurimeve në Kosovë

Kapitulli VIII i Rregullores Nr. 2001/25 mbi Licencimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Sigurimeve, në Kapitullin VIII adreson në mënyrë të qartë Qeverisjen korporative për kompanitë e sigurimeve, por ka pjesë në Kapitullin VII - Faktorët financiarë dhe Kapitullin VI - Çështje të prudencës (çështje të kujdesit) që po ashtu adresojnë çështje të ndërlidhura me qeverisjen korporative.

Neni 52.1 ka të bëjë me përgjegjësitë fiduciare (të besimit) të drejtorëve dhe zyrtarëve dhe specifikon se shkelja e tyre përbën bazë për vendosjen e sanksioneve dhe masave të tjera nga ana e BPK-së. Neni 52.2 thekson se refuzimi i Bordit të drejtorëve për të ndërmarrë veprim pasi të jetë konstatuar një shkelje e qartë e detyrimit fiduciar, i jep të drejtë BPK-së të vendosë sanksione shtesë ndaj kompanisë së sigurimeve. Sipas Neni 52.3, drejtorët dhe zyrtarët e një kompanie të sigurimeve dhe zyrtarët përfaqësues të degës i nënshtrohen kriterit “i përshtatshëm dhe adekuat”. Drejtorët dhe zyrtarët e lartë të një kompanie të sigurimeve dhe zyrtarët përfaqësues të degëve nuk lejohet të mbajnë më shumë se një pozitë në kompani, nëse mbajtja e dy vendeve shkakton konflikt interesi (neni 52.4). Kjo pjesë është ndryshuar me Rregullën 4, e cila ka hyrë në fuqi në janar 2006.

Drejtorëve dhe zyrtarëve mundet, në çdo kohë, t'ju kërkohet të ofrojnë dëshmi se ata nuk janë duke u hetuar për vepra penale (neni 52.5). BPK është përgjegjëse për shqyrtimin e CV-së së drejtorëve, zyrtarëve dhe zyrtarëve përfaqësues të degëve të propozuar (neni 52.6) dhe mund të refuzojnë çdo propozim duke marrë për bazë arsyetimin se interesi i kompanisë dhe i tregut të sigurimeve nuk është përmbushur në mënyrën më të mirë (nenet 52.7 dhe 52.8).

Neni 53.1 thotë se secila kompani e sigurimeve do të administrohet nga një Bord i drejtorëve që përbëhet nga një numër tek, dhe jo më pak se pesë anëtarësh. Bordi i drejtorëve do të zgjidhet nga aksionarët, ndërsa Tubimi i përgjithshëm i aksionarëve përcakton kompensimin për anëtarët e Bordit (neni 53.2). Bordi ka për detyrë t'i përcaktojë politikën, procedurat dhe praktikën, të cilat kompania duhet t'i zbatojë dhe implementojë (neni 53.3), dhe si përgjegjësi primare e ka ruajtjen e interesave të poseduesve të policave (neni 53.4). Drejtorët e kompanisë së sigurimeve duhet të sigurojnë se rezervat teknike janë të mjaftueshme, se minimumi i margjinës së aftësisë paguese/kapitalit dhe i kërkesave për rezerva siç është përcaktuar nga BPK respektohet gjatë gjithë kohës dhe se kompania ka likuiditet të mjaftueshëm gjatë gjithë kohës (neni 53.5). Kjo pjesë është elaboruar më hollësisht në Rregullën 24, që ka hyrë në fuqi në prill 2002.

Neni 54.1 dhe 54.2 kërkojnë që zyrtari i lartë i kompanisë së sigurimit të jetë anëtar i Bordit të drejtorëve, por nuk mund të jetë kryesues i Bordit. Ai/ajo duhet të jetë banor i Kosovës.

Neni 55.1 ka të bëjë me mbajtjen e kontrollit adekuat të brendshëm, përpilimin e politikave, procedurave dhe praktikave plotësisht të dokumentuara për blerjen e obligimeve dhe aktivitetet investuese. Neni 55.2 i jep të drejtë BPK-së të përshkruajë kërkesa shtesë për kontroll të brendshëm përmes rregullave dhe urdhërave.

Neni 56.1 specifikon që drejtorët, zyrtarët dhe punonjësit e një kompanie sigurimi do të veprojnë në një mënyrë të besueshme – fiduciare- për të ruajtur interesat e mbajtësve të policave. Të gjitha transaksionet me palët e ndërlidhura, përveç atyre që parashihen nga BPK, janë të ndaluara (neni 56.2 dhe 56.3). Kjo elaborohet më hollësisht në Rregullën 27, që është në fuqi nga prilli 2002.

Neni 48.1 dhe 48.2 kërkojnë zbatimin e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit nga kompanitë e sigurimit si dhe mbajtjen e sistemeve adekuate të kontabilitetit dhe librave duke përfshirë Regjistrin e primeve, Librin e primeve, Raportin e primeve, Regjistrin e dëmeve, Raportin e dëmeve dhe Librin e përgjithshëm. Kjo pjesë është ndryshuar me Rregullën 7, që është në fuqi që nga prilli i vitit 2002.

Nenet 49.1, 49.2 dhe 49.3 kërkojnë nga kompanitë e sigurimeve që të auditojnë llogaritë e tyre në baza vjetore nga një firmë e licencuar, e aprovuar nga BPK, për të evituar konfliktin e interesit. Neni 49.4 definon detyrat e firmës së auditimit dhe neni 49.5 kërkon nga firma e auditimit që të japë një mendim nëse kompania e sigurimeve iu ka përmbajtur ose jo rregulloreve dhe rregullave të aplikueshme të aprovuara nga BPK. Firma e auditimit duhet të raportojë drejtpërdrejt të BPK nëse kupton se kompania e sigurimeve ka kryer shkelje dhe veprime mashtruese (neni 49.6). Kjo pjesë është ndryshuar me Rregullën 8, që është në fuqi nga janari 2007.

Neni 50.1 specifikon se fundi i vitit financiar për kompanitë e sigurimeve është 31 dhjetori dhe pasqyrat financiare të konsoliduara dhe të audituara për vitin paraprak financiar duhet të dorëzohen jo më vonë se data 30 prill. Secila kompani e sigurimeve duhet të dorëzojë në BPK raporte tremujore që paraqesin likuiditetin, aftësinë e pagesës dhe profitabilitetin (neni 50.2).

Nenet 39.1 dhe 39.2 specifikojnë se ndërrimi i firmës së auditimit, ekspertit të sigurimeve, drejtorëve ose zyrtarëve, kërkon aprovim paraprak me shkrim nga BPK.

Ndryshimet në Bordin e drejtorëve ose të zyrtarëve duhet t'i raportohen dhe shpjegohen BPK-së.

Krahasuar me parimet e OECD-së, rregullat dhe rregulloret e tregut të sigurimeve në Kosovë janë në një situatë të ngjashme me rregullat dhe rregulloret e sistemit bankar, gjë që është e pritshme, sepse është i njëjti organ ai që rregullon dhe monitoron të dy industrinë.

Si përfundim, korniza ligjore dhe rregulluese, me të cilën qeveriset veprimtaria e bankave dhe kompanive të sigurimit në Kosovë, është në zbatim për një kohë relativisht të shkurtër. Proporcioni i "legjislacionit" që ka të bëjë me qeverisjen korporative, megjithatë, mbetet i pakët. Sidoqoftë, është e rëndësishme se një pjesë e madhe e fokusit vendoset në transparencën e këtyre institucioneve. Kriteri "i përshtatshëm dhe adekuat" që aplikohet për aksionarët, menaxherët e lartë në banka dhe për zyrtarët e tjerë në industrinë e sigurimeve, është një hap i rëndësishëm për të ndërtuar besimin në cilësinë e faktorit njeri, faktor ky që është duke u pranuar si qenësor për funksionimin e shëndoshë të këtyre institucioneve.

Një fakt që nuk mund të mos përmendet është se të dy rregulloret dhe shumica e rregullave datojnë nga viti 1999 dhe 2001, kohë kjo kur Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrje Bankare kishte nxjerrë kornizën për kontroll të brendshëm (1998) dhe OECD kishte publikuar për herë të parë parimet e Qeverisjes korporative (1999).

4. GJENDJA E TANISHME E QEVERISJES KORPORATIVE NË BANKA DHE KOMPANI TË SIGURIMIT – Rezultatet e anketës

Anketa e bankave dhe kompanive të sigurimit në Kosovë është zhvilluar gjatë periudhës në mes të javës së kaluar të dhjetorit 2008 deri në javën e parë të shkurtit 2009. Intervistat u mbajtën me 16 persona, të cilët përfaqësonin bordet ose menaxhmentet e gjashtë bankave (nga 8 prej tyre) dhe gjashtë kompani të sigurimit (nga dhjetë sosh) që funksionojnë në Kosovë. Për më tepër, intervista të hollësishme janë zhvilluar me përfaqësues të Bankës Qendrore, Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Aleancës Kosovare të Biznesit, Zyrës së kryeministrit. Rezultatet e hulumtimit na mundësuan një vështrim më të mirë të situatës në qeverisjen korporative dhe zbatimin e Parimeve të OECD-së në këto industri. Më tutje raporti nga anketa do të paraqitet dhe diskutohet në pesë nëntituj, duke adresuar parimet e OECD-së, nga i dyti deri në të gjashtin.

4.1 Të drejtat e aksionarëve dhe funksionet kyçe të pronësisë

Parimi i dytë¹⁴ i OECD-së sugjeron që “Korniza e qeverisjes korporative duhet të mbrojë dhe lehtësojë të drejtat e aksionarëve”. Hulumtimi ka treguar, në mesatare, që bankat në Kosovë të kenë 18.5 aksionarë, kurse kompanitë e sigurimit 2.1 aksionarë. Hulumtimi gjithashtu tregon se metoda kryesore e thirrjes së mbledhjes së aksionarëve është nëpërmes postës elektronike. Dy të tretat e bankave dhe shumica e kompanive të sigurimit e përdorin këtë metodë të thirrjes, edhe pse disa prej tyre thirrjet i bëjnë nëpërmes mediave dhe mjeteve më tradicionale siç është telefoni dhe ftesa nëpërmes postës.

Një të tretat e bankave në anketë i thërrasin mbledhjet e tyre të aksionarëve një muaj më herët, kurse një e tretë tjetër i bën thirrjet dy javë para mbledhjes, ndërsa një e treta tjetër e mbetur i thërret mbledhjet një javë më herët. Së bashku me kohën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes së aksionarëve, bankat i bëjnë të njohura edhe agjendën e mbledhjes dhe materialet për shqyrtim, për dallim nga kompanitë e sigurimit, ku vetëm gjysma e tyre e ndjekin këtë praktikë.

Në një të anë, gjysma e bankave të anketuara kërkojnë 50%+1 aksione/vota për të vendosur një pikë në agjendë të mbledhjes së aksionarëve, kurse një e treta e bankave të anketuara kërkojnë 25% ose më pak të aksioneve ose votave (me disa banka të cilat kërkojnë edhe vetëm 10%). Kurse, në anën tjetër, vetëm një e treta e kompanive të sigurimit kërkojnë 50%+1 aksione për të vendosur një pikë në agjendë të mbledhjes së aksionarëve, ndërsa dy të tretat e tjera të respondentëve nuk iu kanë përgjigjur kësaj pyetjeje. Në gjysmën e bankave të anketuara, për zgjedhjen dhe largimin e anëtarëve të Bordit kërkohet 50% + 1 të votave të aksionarëve, kurse në një të anë bankë kjo çështje kërkon 100% të votave.

Dy banka të intervistuar nuk iu kanë përgjigjur kësaj pyetjeje. Po ashtu, gjysma e kompanive të intervistuar të sigurimit nuk iu kanë përgjigjur kësaj pyetjeje. Kurse, një e treta e respondentëve nga industria e sigurimit kërkojnë 50% + 1 të votave të aksionarëve për të bërë zgjedhjen dhe largimin e anëtarëve të Bordit, kurse një kompani e intervistuar siguri kërkon 100% të votave të aksionarëve.

Tabela 7: Të drejtat e aksionarëve dhe funksionet kyçe të pronësisë

¹⁴ Filluam me parimin e dytë të OECD për qeverisje korporative pasi që ky parim ka të bëjë me sigurimin e themeleve për një kornizë efektive të qeverisjes korporative, dhe kjo është adresuar në kuadër të Kornizës ligjore dhe rregullatore të këtij raporti.

Pyetjet / Pyetësori	Përgjigjet	Numri i bankave	Numri i kompanive të sigurimit
Numri i aksionarëve	Mesatare	18.5	2.1
	Max ¹⁵	40	4
	Min	2	1
Si është thirrur mbledhja e aksionarëve?	Web faqja e kompanisë	-	-
	Thirrje publike (mediat)	1	1
	Posta elektronike	4	5
	Ftesë me postë	2	-
	Telefon	2	1
	Pa përgjigje	1	1
Sa kohë paraprakisht është thirrur mbledhja e aksionarëve?	Një javë	1	1
	Dy javë	2	1
	Një muaj	2	3
	Pa përgjigje	1	1
Cilat informata të tjera prezantohen në thirrjen e mbledhjes së aksionarëve përveç datës dhe lokacionit?	Agjenda dhe materialet që priten të aprovohen	6	3
	Të tjera	-	-
	Pa përgjigje	-	3
Cila % e aksioneve (ose votave) kërkohet për të vendosur një temë në agjendën e mbledhjes së aksionarëve?	50% +1 dhe më shumë	3	2
	25% ose më pak	2	-
	Pa përgjigje	1	4
Cila % e votave të aksionarëve është e nevojshme për të zgjedhur/larguar anëtarët e bordeve?	50% +1	3	2
	Tjetër	1	1
	Pa përgjigje	2	3
Cila % e aksionarëve (ose votave) është e nevojshme për të plotësuar apo ndryshuar statusin?	2/3 e aksionarëve	3	3
	Të gjithë aksionarët	2	-
	Tjetër	-	2
	Pa përgjigje	1	1
Cila % e aksionarëve është e nevojshme për të aprovuar shkrirjet, bashkimin, apo blerjet e kompanive të tjera?	2/3 e aksionarëve	3	4
	Të gjithë aksionarët	1	-
	Tjetër	1	1
	Pa përgjigje	1	1

Te gjysma e bankave dhe kompanive të sigurimit të intervistuar kërkohen dy të tretat e aksioneve/votave për ndryshimin e statutit, kurse një e treta e bankave kërkon aprovimin e të gjithë aksioneve, për dallim nga kompanitë e sigurimit që kërkojnë 50% + 1 të votave të aksionarëve për ndryshimin e statutit. Për të aprovuar shkrirjet, bashkimin, apo blerjet e kompanive të tjera, gjysma e bankave kërkojnë dy të tretat e votave të aksionarëve, një bankë kërkon aprovimin e tri të katërtave të aksioneve si dhe një bankë kërkon votat e të gjithë aksionarëve. Për kompanitë e sigurimit, dy të tretat e tyre kërkojnë dy të tretat e votave të aksionarëve dhe një prej tyre kërkon tri të katërtat e

¹⁵ Një nga bankat në mostrën tonë, e cila ka 70% të aksioneve në degën e vet në Kosovë, është e prezantuar në bursën e shtetit të vet dhe ne besojmë se mund të supozojmë se ka qindra ose mijëra aksionarë.

votave të aksionarëve. Hulumtimi ynë rezulton në faktin se aksionarët janë të informuar në mënyrë adekuate dhe me kohë.

Gjithashtu, ka indikacione se të drejtat e aksionarëve respektohen dhe ata mund të ushtrojnë funksionet e tyre kyçe. Çështje tjetër është se vetëm një numër relativisht i vogël i aksionarëve në të dy industritë u kushton rëndësi kësaj. Ne, megjithatë, nënvizojmë faktin se një proporcion goxha i ndjeshëm i pyetjeve në këtë seksion nuk ka nxitur ndonjë reagim të përfaqësuesve të bankave dhe/apo të kompanive të sigurimit. Pavarësisht kësaj, rezultatet e hulumtimit tregojnë se niveli i përmbushjes së parimit të dytë të OECD-së është i pranueshëm. Por, kjo gjë duhet të merret me kujdes, pasi që një pjesë e madhe e pyetjeve në këtë seksion nuk kanë marrë përgjigje nga përfaqësuesit e bankave dhe të kompanive të sigurimeve.

4.2. Trajtimi i barabartë i aksionarëve

Parimi i Tretë për Qeverisje Korporative të OECD-së thekson: “Korniza e qeverisjes korporative duhet të sigurojë trajtim të barabartë të të gjithë aksionarëve, duke përfshirë aksionarët e vegjël dhe të huaj. Të gjithë aksionarët duhet të kenë mundësinë të adresojnë në mënyrë efektive shkeljet e të drejtave të tyre”. Rezultatet e përmbledhura të hulumtimit tonë në lidhje me zbatimin e këtij parimi, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 8: Trajtimi i barabartë i aksionarëve

Pyetjet / Pyetësi	Përgjigjet	Bankat	Kompanitë e sigurimit
Si i adresoni dhe merreni me shqetësimet e aksionarëve të vegjël?	Mekanizmat formalë	-	-
	Tjetër	3	2
	Pa përgjigje	3	4
A mund të votohet në mungesë?	Po	5	2
	Jo	1	1
	Tjetër	-	3
A kushton votimi në mungesë?	Po	-	-
	Jo	5	2
	Pa përgjigje	1	4

Çështja e aksionarëve të vegjël, në rastin e Kosovës, siç tregojnë edhe rezultatet e anketës, nuk është e një rëndësie të madhe për shkak të mungesës së bursës në Kosovë, ku aksionet e këtyre institucioneve do të mund të tregtohen publikisht. Kjo nënkupton që njerëzit e zakonshëm të mos jenë në gjendje të blejnë numër të caktuar aksionesh, por kjo mbetet privilegj i vetëm disa njerëzve, të cilëve u jepet rasti i blerjes së një sasive substanciale të aksioneve, gjë që në fakt kufizoi numrin e aksionarëve (deri në maksimum 40), siç tregon edhe anketa (Tabela 7).

Numri i vogël i aksionarëve e ka relativizuar problemin e aksionarëve të vegjël. Mënyra se si këto institucione merren me shqetësimet e aksionarëve të vegjël varet nga prejardhja e kapitalit të këtyre bankave, pra nëse këto institucione janë banka me kapital të huaj apo me kapital vendor. Bankat me kapital të huaj mbështeten në kulturën korporative dhe ligjet e vendit të bankës “mëmë” për t’u marrë me këto shqetësime, kurse bankat me kapital vendor nuk duket se kanë një mekanizëm formal, ose së paku ndonjë element të cilin ne kemi qenë në gjendje ta detektojmë në hulumtimin tonë.

Në mostrën tonë të përgjithshme të bankave, gjysma e respondentëve nuk kanë dhënë përgjigje në pyetjen: “Si i adresoni dhe merreni me shqetësimet e aksionarëve të vegjël?”. Gjysma tjetër i janë përgjigjur pyetjes me mungesën e definimit të mekanizmit për adresimin e shqetësimeve të aksionarëve të vegjël. Disa përgjigje tregojnë se ekziston një “marrëveshje” ndërmjet aksionarëve të mëdhenj dhe të vegjël për t’u shprehur nëpërmjet delegimit të votës; dhe në rastin e një banke, aksionarët e vegjël përfaqësohen me anëtarin e tyre në Bord; gjithashtu, mundësia për të diskutuar hapur të gjitha çështjet në Kuvendin e përgjithshëm vjetor, ishte përgjigja e një përfaqësuesi tjetër të bankës në këtë drejtim; madje kishte edhe përgjigje se në disa banka të gjitha vendimet deri më tani janë sjellë me konsensus. Ajo çfarë mungon në këto përgjigje është ajo se çfarë ndodh nëse një aksionar i vogël ka ndonjë shqetësim, d.m.th, nëse të drejtat e tij janë dhunuar?

Diskutimi i hapur në Kuvendin vjetor ofron mundësinë e bërjes publike të shqetësimit të aksionarëve, dhe bashkëndjesinë e aksionarëve të tjerë, por kjo mundësi këtu përfundon. Fakti se të gjitha vendimet deri më tani janë marrë me konsensus, nuk garanton se kjo do të ndodhë edhe në të ardhmen.

Për dallim nga bankat, kompanitë e sigurimit kanë maksimalisht nga katër aksionarë (në mesatare 2.1 aksionarë për një kompani). Fakti se aksionet e një të tretës së kompanive në hulumtimin tonë zotërohen nga një aksionar, dhe një e treta tjetër e kompanive zotërohen nga dy aksionarë, tregon se problemi i aksionarëve të vegjël është marginal, edhe për faktin se kompanitë e zotëruara nga dy, tre ose katër aksionarë, zakonisht paraqesin njërin nga disa biznese të tjera, të cilat janë themeluar nga këta njerëz bashkërisht në të kaluarën. Prandaj, ekziston një shkallë e besimit reciprok që është ndërtuar gjatë kohës ndërmjet këtyre aksionarëve – edhe në rastet kur njëri prej tyre posedon më shumë aksione se të tjerët. Ky fakt është me rëndësi të theksohet, sepse nëse njëri nga aksionarët mban shumicën e aksioneve në kompani të sigurimit, nuk do të thotë që kjo ndodh edhe në bizneset e tjera të përbashkëta, prandaj, rrjedhimisht, motivi për të abuzuar me të drejtat e aksionarëve të vegjël është i minimizuar. Kjo konfirmohet nga përgjigjet e siguruara në anketën tonë. Vetëm dy të tretat e respondentëve iu përgjigjën pyetjes “Si i adresoni dhe merreni me shqetësimet e aksionarëve të vegjël?” duke ofruar përgjigje të tipit: interesat e tyre janë marrë parasysh, ose të gjitha vendimet janë marrë me konsensus, gjë që është shumë e mundshme kur janë një, dy, ose tre aksionarë.

Votimi në mungesë është i mundshëm në shumicën e bankave, pa ndonjë kosto të shprehur. Pra, sipas anketës tonë, kjo u siguron aksionarëve një metodë tjetër të ushtrimit të së drejtës së tyre për të votuar. Kompanitë e sigurimit, në anketën tonë, janë pak më shumë të rezervuara ndaj votimit në mungesë. Vetëm disa prej tyre aplikojnë mundësinë e ‘votimit në mungesë’. Një kompani e sigurimit u përgjigj negativisht ndaj kësaj mundësie, kurse disa të tjera u përgjigjën se “deri më tani nuk iu ka rastisur të përballen me këso lloj situatë”.

Sa i përket aksionarëve të vegjël, nuk ka ndonjë indikacion se të drejtat e tyre janë dhunuar, pasi që edhe në banka dhe kompani të sigurimit me aksionarë të huaj, ata paraqesin shumicën e aksionarëve.

Për të dhënë një përmbledhje, rezultatet tona të hulumtimit nuk kanë mbledhur ndonjë fakt se bankat dhe kompanitë e sigurimit nuk i respektojnë barabartë aksionarët e vet. Sidoqoftë, ne e vlerësojmë shqetësues faktin se nuk ekzistojnë mekanizma për të mbrojtur aksionarët e vegjël. Dhe, përderisa ne mund të ndjehemi rehat për shkak të faktit se deri më tani nuk janë shkelur të drejtat e aksionarëve të vegjël, vetë mungesa e

rregullave dhe rregulloreve në këtë fushë mund të nxisë në të ardhmen sjellje të tilla abuzuese.

4.3. Roli i palëve të interesuara në Qeverisjen korporative

Pala e interesuar është një person ose grup, i cili prek dhe/ose mund të preket nga veprimet e një kompanie. Parimi i Katërt i OECD-së për qeverisje korporative e definon rolin e palës së interesuar si vijon: “Korniza e qeverisjes korporative duhet të njohë të drejtat e palëve të interesuara, të cilët janë definuar me ligj ose nëpërmes marrëveshjes reciproke dhe të inkurajojë bashkëpunimin aktiv në mes të korporatave dhe palëve të interesuara në krijimin e pasurisë, vendeve të punës dhe qëndrueshmërisë financiare të ndërmarrjeve”.

Çështja e palëve të interesuara për industrinë e bankave dhe kompanive të sigurimit në Kosovë nuk është e rregulluar, prandaj mbetet te bankat dhe kompanitë e sigurimit të adresojnë këtë çështje si iu përshtatet më së miri. Kjo rrethanë ka çuar në situatën kur palët e interesuara janë të adresuara vetëm në kuadër të marrëdhënieve të publikut. Anketa reflekton faktin e mungesës së kërkesës ligjore veçanërisht për përfaqësuesin e të punësuarve. Në tabelën e mëposhtme mund të gjenden rezultatet e përmbledhura të anketës:

Tabela 9: Roli i palëve të interesuara

Pyetjet / Pyetëtori	Përgjigjet	Bankat	Kompanitë e sigurimit
Cili nga të pranishmit konsiderohet palë e interesuar nga kompania juaj?	Huamarrësit	6	-
	Depozituesit	6	-
	I siguruari	-	1
	I punësuarit	5	1
	Komuniteti	6	1
	Të tjerët	-	-
	Pa përgjigje	-	5
A ka institucioni juaj sistem të sigurimit të depozitave?	Po	1	-
	Jo	5	-
A ka institucioni juaj përfaqësues të punëtorëve në Bord?	Po	-	1
	Jo	6	5

Kur u kërkua të identifikojnë palët e interesuara për kompanitë e tyre, të gjitha bankat në anketën tonë renditën huamarrësit, depozituesit dhe komunitetin, dhe shumica e bankave gjithashtu renditën të punësuarit si palë e tyre e interesuar. Një gjetje interesante për kompanitë e sigurimit ishte se vetëm një pakicë (1) i renditi “të siguruarit” si palë e interesuar, dhe një pakicë e ngjashme (1) i renditi “të punësuarit” dhe “komunitetin” si palë e tyre e interesuar. Shumica e kompanive të sigurimit (5) zgjodhën heshtjen në pyetjen lidhur me palët e tyre të interesuara.

Kur u pyetën respondentët lidhur me aktivitetet e institucioneve të tyre në drejtim të kultivimit të marrëdhënieve me palët e interesuara, shumica e kompanive të sigurimit, si edhe shumica e bankave, theksuan marrjen e masave për të përmirësuar shërbimet ndaj klientëve. Sidoqoftë, të gjitha bankat dhe shumica e kompanive të sigurimit janë të

orientuara pozitivisht ndaj sponsorizimit të aktiviteteve sportive/argëtuese, dhe gjithashtu ndaj projekteve të gazetarisë hulumtuese dhe programeve edukative.

Një rezultat i pritur për shkak të mungesës së rregullore, është se shumica e bankave nuk kanë sigurim të depozitave (5), kurse një pakicë (1, që është degë e një banke ndërkombëtare), i është përgjigjur pozitivisht pyetjes sonë. Edhe pse shumica e bankave në anketën tonë kanë deklaruar se i konsiderojnë të punësuarit si palë të interesuar, asnjë prej tyre nuk kanë përfaqësues të punëtorëve në Bord. E njëjta situatë është edhe me shumicën e kompanive të sigurimit.

Sa i përket funksionalitetit dhe kualitetit të Bordit të drejtorëve, përfaqësuesi i OEK-ut u fokusua më shumë në përvojat të cilat shoqëruan themelimin dhe funksionalitetin e bankave dhe iu referua Qeverisjes korporative si problemin kryesor të kohës. Ndarja e dobët e funksioneve dhe përgjegjësi ndërmjet organeve qeverisëse është shenjë kryesore e bankave me kapital vendor. Prezenca e bankave me kapital të huaj ka sjellë praktika më të mira të Qeverisjes korporative në sektorin bankar, sipas përfaqësuesit të OEK-ut. Sipas tij, kriteri i normave etike, profesionale dhe të integritetit personal, është një nga faktorët më kryesorë që ndikon pozitivisht në funksionalitetin dhe cilësinë e bordeve. Përpunimi i informatave për personat që aplikojnë për pozita të anëtarëve të bordeve dhe menaxhmentit të lartë, përfshin një rrjet të agjencive jashtë BQK-së, si Njësia e Inteligjencës Financiare (FIU) që ka funksionuar si agjenci e UNMIK-ut. Për bankat me kapital të huaj informatat verifikohen tek institucionet respektive të vendit ‘mëmë’. Lidhur me kompanitë e sigurimit kriteret janë më të ashpra pasi që menaxhmenti i nivelit të mesëm, si për shembull drejtorët e njësive, u nënshtrohen këtyre procedurave gjithashtu. Përfaqësuesi i BQK-së ka deklaruar se anëtarët e pavarur të bordeve u nënshtrohen procedurave të njëjta para miratimit nga BQK-ja. I pyetur për opinionet e tij në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet institucioneve financiare dhe palëve të interesuara, përfaqësuesi i OEK-ut mendon se komunikimi ndërmjet këtyre akterëve është në një nivel të pakënaqshëm.

Përfaqësuesi i BQK-së sugjeron që marrëdhëniet ndërmejt institucioneve financiare dhe palëve të interesuara ndërlidhen me kualitetin e raportimit dhe bërjes publike. Ekziston një “kornizë e raportimit” të cilën institucionet financiare duhet ta respektojnë dhe gjithashtu ka rregullore strikte sa i përket publikimit të raporteve të audituara dhe pasqyrave financiare. Gjithashtu, të gjitha bankat dhe kompanitë e sigurimit duhet të bëjnë publike në web faqet e tyre normat e interesit dhe tarifat e premive, kurse për bankat me kapital të huaj ekziston kërkesa për të publikuar raportet e tyre financiare për tërë grupin të cilit i takojnë. Kjo rrit transparencën e institucioneve financiare karshi palëve të interesuara, përfundon përfaqësuesi i OEK-ut, duke shtuar se mbrojtja e të drejtave të aksionarëve dhe transaksionet e palëve të ndërlidhura duhet të rregullohen me ligj.

Përfaqësuesi i BQK-së konfirmoi se është i qartë definimi i palëve të ndërlidhura dhe se ekzistojnë kufizime në lidhje me vlerën e kredisë që mund t’i jepet menaxhmentit të bankës dhe punëtorëve. Kruciale në këtë drejtim është ndarja e postit mes kryesuesit të Bordit dhe kryeshefit ekzekutiv, e cila kontribuon në pavarësinë e këtyre dy organeve. Në fund, sa i përket zbatimit të parimeve të OECD-së, përfaqësuesi i OEK-ut deklaroi se kjo gjë ndodh pjesërisht dhe se ka hapësirë për përmirësim. Ndërkaq, sipas përfaqësuesit të BQK-së, të gjitha kompanitë e sigurimeve i zbatojnë parimet e OECD-së, pasi që Asociacioni i Mbikëqyrësve të Sigurimeve vepron sipas parimeve të OECD-së. Bankat, ndërkaq, nuk janë të obligueshme të zbatojnë parimet e OECD-së, pasi që rregulloret janë të bazuara në Parimet e Komitetit të Bazelit për Qeverisje Korporative. Nëpërmes

“letrave këshilluese” BQK-ja ka adoptuar parimet e Bazelit në tregun kosovar të bankave. Në të ardhmen, parashihet implementimi i Bazelit II, dhe pritet që kjo të rrisë standardet menaxheriale dhe të përmirësojë Qeverisjen korporative.

Për të bërë një përmbledhje, roli i palëve të interesuara nuk është i rregulluar dhe të dy palët, edhe bankat edhe kompanitë e sigurimit, sipas anketës sonë, kanë treguar mangësi në këtë drejtim. Përshtypja e disa palëve të interesuara, më saktësisht e disa përfaqësuesve të komunitetit të biznesit (Oda Ekonomike dhe Aleanca Kosovare e Biznesit), është se sistemi financiar, normat e larta të interesit dhe periudha e shkurtër kohore për kthimin e kredisë nuk janë duke plotësuar në mënyrë adekuate nevojat e bizneseve për investime afatgjata kapitale.

Gjithashtu, rezultatet nga anketat me ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të zhvilluara gjatë disa viteve të kaluara kanë treguar në mënyrë konstante se qasja në financa dhe kushtet kredituese janë peshuar si ndër pengesat kryesore të bërjes biznes në Kosovë¹⁶. Siç është thënë në kapitullin 3, intensiteti i kredisë i shprehur nëpërmjet treguesit kredi private / GDP tregon në fakt një kërkesë dhe ofertë të varfër kredituese të bizneseve dhe ekonomive familjare kosovare krahasuar me vendet fqinje. Kjo reflektohet në një kërkesë konstante të madhe për kredi, me gjithë normat e larta të interesit, e cila gjithashtu sqarohet me rrezikun e perceptuar në lidhje me gjyqësinë joefikase. Sidoqoftë, të gjitha këto që u thanë më sipër, japin të kuptojnë se nuk ka ndjeshmëri të mjaftueshme rreth shqetësimeve kryesore ndërmjet palëve kryesore të interesuara; bankat – bizneset – qeveria dhe institucionet.

4.4. Bërja publike dhe transparencë

Parimi i Pestë i OECD-së mbi Transparencën dhe Bërjen Publike thekson se “Korniza e qeverisjes korporative duhet të sigurojë se janë bërë publike me kohë dhe saktë të gjitha çështjet materiale në lidhje me korporatën, duke përfshirë edhe situatën financiare, performansën, pronësinë dhe qeverisjen e kompanisë”. Në hulumtimin tonë, të gjitha bankat dhe kompanitë e sigurimit iu kanë përgjigjur pozitivisht pyetjes lidhur me publikimin e pasqyrave financiare dhe të rezultateve operative. Kjo përgjigje ka qenë e pritshme, pasi që kërkohet nga legjislacioni ekzistues i këtyre industrive.¹⁷ Ndërkaq, përgjigje të tjera kemi marrë kur kemi të bëjmë me publikimin e objektivave strategjike. Rreth 1/3 e bankave dhe shumica e kompanive të sigurimit (rreth 2/3) nuk i publikojnë objektivat e tyre strategjike.

Publikimi i emrave të aksionarëve të mëdhenj, bazuar në rezultatet e anketës sonë, është një çështje e parregulluar dhe varet prej institucioneve individuale për ta adresuar, edhe pse të gjithë respondentët janë shprehur pozitivisht rreth kësaj teme. Megjithatë, ka pasur dallime ndërmjet bankave sa i përket pragut për deklarimin e aksionarit, ku shumica e respondentëve as nuk kanë dhënë përgjigje, e as nuk kanë qenë të sigurt se ekziston ndonjë kufi apo % e pronësisë së aksioneve si kusht për deklarimin e aksionarit. Sidoqoftë, derisa një respondent u përgjigj se të gjithë aksionarët janë të paraqitur në web faqe, një tjetër respondent deklaroi se ata deklarojnë vetëm tetë aksionarët më të mëdhenj; kurse përgjigja e respondentit të tretë ishte se 7% e pronësisë është e nevojshme për të deklaruar një aksionar.

¹⁶ Anketat me NVM, Riinvest 2004, 2005, 2008

¹⁷ Për industrinë bankare është Rregullorja Nr. 1999/21, seksionet 28, 32, 35, 36 dhe Rregullat e Amendamentuara XI dhe XXIV, kurse për industrinë e sigurimeve është Rregullorja Nr. 2001/25 provizionet 50.1, 50.2, Rregulli 7 dhe Rregulli 8.

Tabela 10: Bërja publike dhe transparencja

Pyetjet / Pyetësi	Përgjigjet	Bankat	Kompanitë e sigurimit
A i publikoni pasqyrat tuaja financiare dhe rezultatet operative?	Po	6	6
	Jo	-	-
A i publikoni objektivat strategjike të kompanisë?	Po	4	2
	Jo	2	4
A i publikoni emrat e aksionarëve të mëdhenj?	Po	6	6
	Jo	-	-
A ekziston ndonjë kufi apo % e pronësisë si kusht për të deklaruar aksionarin?	Po	3	-
	Jo	1	1
	Pa përgjigje	2	5
A i publikoni informatat për anëtarët e bordeve?	Po	6	4
	Jo	-	2
A keni ndonjë anëtar të pavarur në Bordin e drejtorëve?	Po	-	4
	Jo	6	2
A e ndriçoni kompensimin e menaxherëve dhe anëtarëve të bordeve?	Po	-	1
	Jo	3	3
	Tjetër (Po, ndaj BQK-së)	3	2
A ka institucioni juaj politikë të definuar për të bërë biznes me kompanitë në të cilat anëtarë tuaj të bordeve janë aksionarë me rëndësi ose të punësuar?	Po	4	5
	Jo	2	1
A ka institucioni juaj politikë të definuar për të bërë biznes me kompanitë në të cilat anëtarët tuaj të menaxhmentit kanë numër 'të konsiderueshëm' të aksioneve?	Po	5	-
	Jo	1	1
	Pa përgjigje	-	5
A i publikoni raportet tuaja të audituara?	Po	6	618
	Jo	-	-
Sa shpesh i caktoni auditorët e rinj të jashtëm (tjerë nga ata të tanishmit apo të kaluarit)?	Çdo tre vjet	2	-
	Çdo të pestin vit	4	2
	Çdo vit	-	4

Situata me kompanitë e sigurimit ishte më e thjeshtë. Vetëm një nga respondentët u përgjigj negativisht rreth ekzistimit të ndonjë pragu për deklarimin e aksionarit, kurse pjesa tjetër e respondentëve nuk u deklarua për këtë çështje. Edhe njëherë, kjo do të mund të shpjegohej me faktin se ekziston një numër i vogël i aksionarëve për kompani (në mes 1 dhe 4) dhe ndoshta respondentët kanë supozuar gjatë intervistës se është e qartë se të gjithë aksionarët janë bërë publikë.

¹⁸ Një kompani e sigurimit nuk u përgjigj për shkak se ishte kuartali i parë i funksionimit të saj dhe akoma nuk kishte raporte të audituara.

Sipas rezultateve të anketës, bankat janë goxha transparente sa i përket publikimit të informatave¹⁹ lidhur me anëtarët e tyre të bordeve. Dy të tretat e bankave i janë përgjigjur pozitivisht pyetjes lidhur me publikimin e informatave të tilla, një e treta publikojnë CV-në e plotë dhe kualifikimet. Gjëja e përbashkët e bankave lidhur me këtë temë është se gjysma e tyre publikojnë kualifikimet e anëtarëve të bordeve. Disa banka publikojnë një biografi të shkurtë përveç kualifikimeve të anëtarëve të bordeve. Por, fakti mbetet se një e treta e bankave në anketën tonë nuk publikojnë informata për anëtarët e bordeve të tyre. Asnjëra prej bankave nuk publikon informata lidhur me shpërblimet e menaxherëve të bankës, apo të anëtarëve të Bordit të bankës.

E njëjta gjë ndodh me kompanitë e sigurimit. Dy të tretat e tyre publikojnë informata për anëtarët e bordeve; por, sipas hulumtimit, ata i publikojnë vetëm emrat dhe përqindjet e pronësisë. Një kompani në anketën tonë u përgjigj se vetëm një profil i shkurtër i anëtarëve të bordeve publikohet. Në lidhje me këtë, anketa jonë tregon se as bankat e as kompanitë e sigurimit nuk publikojnë informata lidhur me procesin përzgjedhës të anëtarëve të bordeve, ose informata lidhur me pozitat e tjera udhëheqëse.

Ndoshta, çështja më intriguese që del nga hulumtimi është fakti se të gjitha bankat janë përgjigjur negativisht në pyetjen lidhur me anëtarët e pavarur të bordeve.²⁰ Në këtë aspekt, kompanitë e sigurimit ndryshojnë nga bankat, pasi që përgjigjet nga industria e sigurimeve ishin se dy të tretat e tyre kanë drejtorë të pavarur në bordet e tyre, gjë që tregon se një e treta e kompanive të sigurimit nuk kanë anëtarë të pavarur të Bordit.

Gjysma e bankave dhe kompanive të sigurimit në anketën tonë ia bëjnë të njohur autoritetit rregullues kompensimin e anëtarëve të bordeve dhe menaxherëve. Gjysma tjetër e trajton kompensimin e anëtarëve të bordeve dhe menaxherëve konfidenciale. Sa i përket transaksioneve me palët e ndërlidhura, të gjitha bankat, përveç njëjës, u përgjigjën pozitivisht në lidhje me politikat e trajtimit të kompanive, në të cilat anëtarët e bordeve dhe menaxherët janë aksionarë me rëndësi dhe të punësuar. Reagimi nga kompanitë e sigurimeve në pyetjen lidhur me transaksionet e palëve të ndërlidhura është i ngjashëm me atë të bankave, pasi që të gjitha prej tyre (përveç njëjës) janë deklaruar se kanë politika që trajtojnë kompanitë në të cilat anëtarët e bordeve të tyre janë aksionarë të rëndësishëm.

Mjaft interesant është fakti se vetëm një kompani u deklarua se nuk ka procedura për adresimin e transaksioneve të palëve të ndërlidhura me kompanitë në të cilat menaxherët janë aksionarë të rëndësishëm ose të punësuar. Kurse, pjesa tjetër e respondentëve nuk u përgjigj fare në këtë pyetje. Në të kaluarën, para dy tri vjetëve, kjo doli të jetë mjaft problematike. Dështimi i aplikimit të standardeve të Qeverisjes korporative çoi në probleme serioze të dy banka kosovare, njëra prej të cilave Credit Bank of Prishtina bankrotoi (2004). Problemi kryesor ishte konflikti i interesit i disa anëtarëve të Bordit të drejtorëve në këto banka duke lëshuar kredi për bizneset e veta ose shoqëruar me defektet për të bërë kthimin e borxheve.

Sa i përket bërjes publike dhe publikimit të informatave financiare, rezultatet e hulumtimit tregojnë se të gjitha bankat dhe kompanitë e sigurimit përdorin standarde të kontabilitetit në përputhje me ato ndërkombëtare. Frekuenca e bërjes publike të

¹⁹ Ne kemi pyetur nëse ndonjë apo të gjitha informatat e mëposhtme janë publikuar:

- CV e plotë;
- Kualifikimet;
- Pozitat e tjera udhëheqëse;
- Procesi përzgjedhës;
- Kompensimi, ose tjetër (të papërmendura në listë)

²⁰ Çfarë e bën këtë intriguese është fakti që sipas Rregullores 1999/21 seksioni 17, dy të tretat e anëtarëve të bordeve duhet të jenë drejtorë joekzekutivë.

informatave është e rregulluar për bankat dhe kompanitë e sigurimit. Gjithashtu rregulloret parashohin publikimin e raporteve të audituara në gazetat²¹ nacionale me kohë. Shumica e bankave në anketën tonë i publikojnë pasqyrat financiare dhe raportet vjetore në ueb faqet e tyre. Disa banka e publikojnë edhe bilancin e gjendjes në gazetata nacionale. Një e treta e bankave në anketën tonë kontraktjnë auditorin e pavarur çdo tre vjet, kurse dy të tretat çdo pesë vjet. Auditori i pavarur në të gjitha bankat u raporton aksionarëve (Kuvendit vjetor të aksionarëve) dhe në gjysmën e bankave edhe Bordit të drejtorëve.

Publikimi i raporteve të audituara ndryshon për kompanitë e sigurimit pasi që nuk është e rregulluar si për bankat. Të gjitha kompanitë e sigurimit në anketën tonë i publikojnë raportet e audituara në ueb faqet e tyre dhe vetëm disa prej tyre e bëjnë këtë gjë edhe në raportet vjetore. Me rastin e deklarimit për caktimin e auditorit të pavarur, një e treta deklaroi se këtë e bën çdo gjashtë muaj, një e treta tjetër çdo vit, kurse një e treta tjetër e mbetur çdo pesë vjet. Në anketën tonë, në rreth 85% të kompanive të sigurimit, auditori i jashtëm i raporton Bordit të drejtorëve, kurse rreth 15% i raportojnë edhe BQK-së, dhe edhe 15% të tjera u raportojnë edhe aksionarëve.

Si rikapitulim, bankat dhe kompanitë e sigurimit në anketën tonë janë treguar të kujdesshme në çështjet e ndërlidhura me transparencë dhe bërje publike të informatave. Bankat në përgjithësi publikojnë më shumë informata se kompanitë e sigurimit. Ndoshta edhe për faktin se Autoriteti rregullativ i ka kushtuar më shumë rëndësi këtyre institucioneve, ka rezultuar në atë që këto institucione të jenë më të përkushtuara në zbatimin e parimit të OECD-së.

4.5. Përgjegjësitë e Bordit

Parimet e Qeverisjes korporative i kushtojnë rëndësi të madhe përgjegjësive të Bordit të ndërmarrjes, edhe pse në praktikë kjo gjë nuk është kuptuar shumë seriozisht nga kompanitë. Kualiteti i kompanisë shpesh mund të gjykohet edhe nga kualiteti i Bordit. Parimi i gjashtë i Qeverisjes korporative të OECD-së nënvizon rolin e Bordit kështu: “Korniza e qeverisjes korporative duhet të sigurojë udhëheqjen strategjike të kompanisë nga Bordi, monitorimin efektiv të menaxhmentit nga Bordi dhe përgjegjësinë e Bordit ndaj kompanisë dhe aksionarëve”. Tabela e mëposhtme jep një përmbledhje të funksionimit të bordeve, sipas anketës.

Në bazë të anketës sonë në banka, pjesëmarrja e anëtarëve të Bordit në takimet e tij është shumë e mirë (100%) dhe relativisht e mirë për kompanitë e sigurimit (2/3 e kompanive kanë pjesëmarrje në mes 80 dhe 100%). Shumica e bankave nuk kanë sistem të vendosur të ndëshkimeve për mospjesëmarrje të anëtarëve në takimet e Bordit. Kurse, një pjesë e bankave shqiptojnë ndëshkime të ashpra për mospjesëmarrje. Kështu, në rast të mospjesëmarrjes dy, respektivisht, tri herë, kryesuesit e bordeve të këtyre bankave mund të kërkojnë shkarkimin dhe zëvendësimin e anëtarit delikuent. Për kompanitë e sigurimit, gjendja është ndryshe. Vetëm njëra prej tyre aplikon dënimet për mospjesëmarrje, kurse tri prej tyre jo. Një nga kompanitë nuk ka dhënë përgjigje. Ndëshkimi për mospjesëmarrje në takime variron prej mospagesës së mëdijtes deri te shkarkimi.

Në bazë të anketës sonë, bordet e drejtorëve të bankave janë takuar më shpesh sesa kompanitë e sigurimit në vitin 2008. Tri banka kanë pasur 12 ose më shumë mbledhje të Bordit, kurse pjesa tjetër janë takuar në baza kuartale apo dymujore. Shumica

²¹ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/21, Seksioni 34.

e kompanive të sigurimit gjatë vitit 2008 janë takuar në baza mujore (5) dhe vetëm një është takuar më shumë se një herë në muaj.

Tabela 11: Përgjegjësitë e Bordit

Pyetjet / Pyetëtori	Përgjigjet	Numri i bankave	Numri i kompanive të sigurimit
Mesatarja (%) e pjesëmarrjes në takimet e Bordit?	100%	6	2
	> 80%	-	2
	Pa përgjigje	-	2
A ka institucioni juaj sistem të ndëshkimit për anëtarët që nuk marrin pjesë në takime?	Po	2	1
	Jo	3	3
	Pa përgjigje	-	2
Sa herë është takuar Bordi në 2008?	Mesatare	12	11.1
	Numri maksimal i takimeve	24	14
Çfarë periudhe kohore mbulon strategjia e korporatës e aprovuar nga Bordi?	Tre vjet	3	2
	Pesë vjet	3	4
A vendos Bordi objektiva të performansës për menaxhmentin?	Po	6	6
	Jo	-	-
A ka kompania objektiva të performansës për anëtarët e Bordit?	Po	3	1
	Jo	2	4
	Pa përgjigje	1	1
Kush monitoron zbatimin e planeve strategjike dhe performansës së korporatës si dhe mbikëqyrjen e shpenzimeve të mëdha kapitale?	Bordi i drejtorëve	-	4
	BD dhe menaxhmenti	5	2
	Tjetër	1	-
A i ka themeluar Bordi komitetet në vijim?	Auditimi	6	5
	Kompensimi	1	-
	Emërimi	2	-
	Rreziku	6	2
	Tjetër	1	2
A vendos Bordi mbi 'politikat e qeverisjes korporative'?	Po	5	5
	Jo	1	1

Në hulumtim, bordet e të gjitha bankave dhe kompanive të sigurimit janë përgjigjur se merren me strategjinë e korporatës, planeve madhore të veprimit, politikat e riskut, buxhetet vjetore dhe planet e biznesit. Gjysma e bankave i kanë të aprovuara strategjitë e korporatës për një periudhë trevjeçare, kurse pjesa e mbetur për një periudhë pesëvjeçare. Një e treta e kompanive të sigurimit i aprovojnë strategjitë e korporatës për një periudhë trevjeçare dhe dy të tretat e mbetura të kompanive i aprovojnë për periudhë pesëvjeçare.

Të gjitha bankat dhe kompanitë e sigurimit të intervistuar deklarojnë se bordet e tyre vendosin objektiva të performansës për menaxhmentin. Kriteri më i shpeshtë për matjen e performansës ishte 'pjesëmarrja në treg' por edhe 'numri i klientëve'. Bordet e bankave shfrytëzojnë gjithashtu kriteret si kualiteti i portfolios, proporcioni i projekteve të implementuara me sukses, arritja e synimeve si rritja e depozitave, zhvillimi i disa linjave të biznesit, etj. Objektivat e tjerë të përdorur nga bordet e kompanive të sigurimit nuk janë aq elaboruese sa të industrisë bankare. Vetëm një kompani e sigurimit ka përdorur 'Zhvillimin dhe trajnimin e stafit' dhe 'kreativitetin' si objektivë e performansës për menaxherët.

Situata ndryshon kur kemi të bëjmë me faktin nëse ekzistojnë objektiva të performansës për anëtarët e bordeve. Vetëm gjysma e bankave në anketën tonë u janë përgjigjur pozitivisht kësaj pyetjeje, për dallim nga dy të tretat e kompanive të sigurimit, të cilat janë deklaruar në mënyrë negative rreth kësaj çështjeje. Objektivat e performansës për anëtarët e bordeve përfshijnë: përfundimi i projekteve në kohë, rritja e profitit të përgjithshëm të bankës, arritja e objektivave sipas planit afatshkurtër dhe afatgjatë, etj. Për kompanitë e sigurimit caku ishte përbushja e planeve me kohë.

Për shumicën e bankave në anketën tonë (5), monitorimi i zbatimit të planeve strategjike dhe performansës së korporatës si dhe mbikëqyrja e shpenzimeve madhore kapitale zhvillohen bashkërisht nga Bordi i drejtorëve dhe menaxhmenti. Në bankën e mbetur këto funksione kryhen nga Komiteti i auditimit²². Për dy të tretat e kompanive të sigurimit në anketën tonë, vetëm Bordi i drejtorëve merret me këto çështje, kurse në një të tretën tjetër të kompanive, bordet e drejtorëve dhe menaxhmentet bashkërisht bëjnë monitorimin e implementimit të planeve strategjike dhe performansës së korporatës si dhe mbikëqyrjen e shpenzimeve madhore kapitale.

Bankat duket të kenë më shumë komitete se kompanitë e sigurimit si në numër ashtu edhe në cilësi. Kjo vlen sidomos për komitetet e auditimit dhe të rrezikut. Disa banka kanë komitetet e emërimeve dhe kompensimit, kurse asnjë nga kompanitë e sigurimit nuk i kanë ato; Disa banka kanë komitete të tjera, si Komiteti i menaxhimit të aseteve/detyrimeve, kurse disa kompani të sigurimit kanë komitete si: për vlerësimin e kërkesave, vlerësimin e rasteve të klientëve, nevojave të trajnimit, etj.

Krejt në fund, bordet vendosin për praktikatat e Qeverisjes korporative në shumicën e bankave dhe kompanive të sigurimit. Zbatimi dhe monitorimi i këtyre praktikave sipas anketës sonë është i ngjashëm për të dy industritë. Raportet nga nivelet e ndryshme të menaxhmentit dhe gjithashtu edhe nga njësitë përkatëse të auditimit shfrytëzohen për të monitoruar dhe zbatuar praktikatat e Qeverisjes korporative.

Sidoqoftë, nga një pjesë e intervistave krijohet përshtypja se anëtarët e bordeve kanë nevojë për më shumë vëmendje lidhur me standardet e avancuara të Qeverisjes korporative dhe parimeve të OECD-së, veçanërisht lidhur me marrëdhëniet ndërmjet aksionarëve – Bordit dhe menaxhmentit.

Si përmbledhje, nga anketa vërehet se bordet në përgjithësi funksionojnë mirë, edhe pse ka disa dallime të vogla në atë se si bordet e bankave dhe kompanive të sigurimit punojnë. Dështimi kryesor në përbushjen e parimit të gjashtë të OECD-së është mungesa e kujdesit për palët e interesuara, gjë që vlen për të dy industritë e anketuara.

²² Një bankë, përveç Komitetit të auditimit, ka edhe Zyrën e brendshme të auditimit.

Referencat:

- Banka Qendrore e Kosovës, Buletini mujor, janar 2009, <http://www.bqk-kos.org/>
- Banka Qendrore e Kosovës, raportet vjetore 2008/7/6/5/4/3/2/1/0.
- Caprio, G. Jr., Levine, R., 2002, Corporate Governance of Banks: Concepts and International Observations, Financial Sector Governance: The Roles of the Public and Private Sectors, Washington DC: The Brookings Institution.
- Diamond D.W., Dybvig, P.H., 1983, Bank runs, deposit insurance, and liquidity, Journal of Political Economy, Volume 91, issue 3, pp. 401– 419.
- Instituti Riinvest (shtator 2008): Trendet Socio-Ekonomike në Kosovë: Përmirësimi i Qeverisjes dhe Tërheqja e Investimeve, www.riinvestinstitute.org
- Instituti Riinvest: Anketa e NVM-ve 2004, 2005, 2008;
- Lannoo, K., 2009, Regulation creates gaps between EU countries, Financial News [internet], 23 February. Available at: <http://www.efinancialnews.com/homepage/comment/content/1053418953> [Accessed 23 March, 2009]
- Levine, R., 2003, The Corporate Governance Of Banks: A Concise Discussion of Concepts and Evidence, Discussion Paper No. 3, Global Corporate Governance Forum
- Macey, J. R., O’Hara, M., 2003, The Corporate Governance of Banks, Economic Policy Review, Volume 9, issue 1, pp. 91-107.
- Shull, B., 2007, Corporate governance, bank regulation and activity expansion in the United States
- Trayler, R., 2007, A survey of corporate governance in banking: characteristics of the top 100 world banks